NDRYSHIMI I PARADIGMËS: KUJDESI SI INVESTIM NË SHQIPËRI.

ANALIZË KOSTO-PËRFITIM PËR ADRESIMIN E MANGËSIVE NË MBULIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT.

Sweden Sverige

UK International Development
Partnership | Progress | Prosperity

UN WOMEN

FOR ALL WOMEN AND GIRLS

© 2026 UN Women.

Ky punim është i disponueshëm për përdorim të hapur, në përputhje me licencën Creative Commons të krijuar për organizatat ndërqeveritare, e cila gjendet në: https://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/3.0/igo/

Botuesit duhet të fshijnë logot e UN Women, qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar dhe qeverisë së Suedisë nga botimet e tyre dhe të krijojnë një dizajn të ri për ballinën e tyre.

Botuesit duhet ta dërgojnë dokumentin e botimit të tyre me email në adresën: permissions@unwomen.org

Fotokopje dhe riprodhime të pjesëve të materialit lejohen me kusht citimin e duhur të burimit.

Krijuar nga UN Women Shqipëri, Tiranë, 2026.Lutemi që këtë botim ta citoni si: UN Women, 2026.“Ekonomia e përkujdesit dhe puna e papaguar e kujdesit në Shqipëri”.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autoreve dhe jo domosdoshmërisht përfaqësojnë pikëpamjet e UN Women, të qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar dhe të qeverisë së Suedisë, ose të ndonjë prej organizatave të lidhura me to.

NDRYSHIMI I PARADIGMËS: KUJDESI SI INVESTIM NË SHQIPËRI.

ANALIZË KOSTO-PËRFITIM PËR ADRESIMIN E MANGËSIVE NË MBULIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT.

Sweden Sverige

UK International Development
Partnership | Progress | Prosperity

UN WOMEN

FOR ALL WOMEN AND GIRLS

FALËNDERIME

Ky studim u hartua nga Juna Miluka[1], eksperte e UN Women, me rishikimin dhe kontribute teknike të Amber Parkes, Specialiste e Politikave të Ekonomisë së Kujdesit pranë UN Women, Michele Ribotta, Përfaqësues i UN Women në Shqipëri, Erisa Cela, Drejtuese e Programeve pranë UN Women, Majlinda Nesturi, Analiste Kërkimesh dhe të Dhënash pranë UN Women dhe Rachele Megna, Specialiste e Menaxhimit të Projekteve pranë UN Women. Për këtë studim, dhanë kontribut aktorë të shumtë, duke përfshirë: Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Shtetit për Qeverisjen Vendore, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, INSTAT-in, Fakultetin e Ekonomisë së Tiranës, ILO-n, UNDP-në, UNICEF-in, Sida-n, dhe përgatitja e tij u mundësua falë mbështetjes së Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar dhe Sida-s.

1 Juna Miluka, Eksperte e UN Women dhe Profesore e Asociouar pranë Universitetit të New York Tiranë

LISTA E SHKURTESAVE

AFD	Agjencia Franceze për Zhvillim
CCG	Boshllëku në Mbulimin e Kujdesit
CEDAW	Konventa për Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave
ECCE	Kujdesi dhe Edukimi në Fëmijërinë e Hershme
BE	Bashkimi Europian
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
LFS	Anketa e Forcave të Punës
LTC	Kujdesi Afatgjatë
NSSP	Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OSHC	Organizata te Shoqerise Civile
OJQ	Organizata jo-qeveritare
INSTAT	Instituti i Statistikave
SDG	Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm
TUS	Anketa e Përdorimit të Kohës
LCS	Anketa e Kostos së Punës
FTE	Ekuivalenti i Punonjësit me Kohë të Plotë
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
GAP	Plani i Veprimit i BE-së për çështjet Gjinore

PARATHËNIE

Kujdesi është thelbësor për funksionimin e ekonomive dhe shoqërive, megjithatë ai vazhdon të nënvlerësohet, të mos marrë investime të mjaftueshme dhe të jepet në mënyrë të pabarabartë. Në të gjithë Europën dhe Azinë Qendrore, presionet demografike, sociale dhe ekonomike në rritje po e bëjnë gjithnjë e më urgjente forcimin e sistemeve të kujdesit në një mënyrë të koordinuar dhe të qëndrueshme. Pavarësisht interesit në rritje të Shqipërisë dhe qeverive të tjera në Ballkanin Perëndimor, progresi mbetet i pamjaftueshëm si në aspektin e shtrirjes, ashtu edhe në atë të shpejtësisë, dhe puna e kujdesit vazhdon të kryhet në mënyrë disproporcionale nga gratë. Në të njëjtën kohë, sistemet e kujdesit po përballen me presione gjithnjë e më të mëdha si pasojë e plakjes së popullsisë, nivelit të ulët të lindjeve, mungesës së fuqisë punëtore dhe migracionit. Ofrimi i fragmentarizuar i shërbimeve të kujdesit, investimet e pamjaftueshme dhe koordinimi i dobët ndërmjet sektorëve kufizojnë aksesin në shërbime kujdesi të përballueshme, cilësore dhe gjithëpërfshirëse.

Ky studim evidenton se këto prirje vazhdojnë të jenë të pranishme edhe në Shqipëri dhe synon të hapë dialogun ndërmjet qeverisë shqiptare, sistemit të OKB-së dhe të gjithë aktorëve përkatës për ta rikonceptuar financimin e ekonomisë së kujdesit jo thjesht si një shpenzim, por si një investim të domosdoshëm në kushtet e tranzicioneve të vazhdueshme demografike dhe si një hap thelbësor në rrugëtimin e Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian.

Kohët e fundit, UN Women ka mbështetur hartimin e Agjendës Rajonale të Veprimit për Kujdesin për Europën dhe Azinë Qendrore, e cila u prezantua zyrtarisht në Forumin për Ekonominë e Kujdesit në Stamboll në muajin maj 2026. Ky udhërrëfyes përfaqëson një përpjekje të përbashkët shumëpalëshe, e cila do të formësohet dhe zbatohet në mënyrë kolektive nga shtetet anëtare, agjencitë e OKB-së dhe aktorët kryesorë që punojnë në fushën e sistemeve të kujdesit, me synimin për të vënë në zbatim angazhimet kryesore ndërkombëtare dhe rajonale në fushën e kujdesit. Këto përfshijnë CEDAW-n, Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit, Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe veçanërisht Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm 5.4, si dhe si dhe Strategjinë e BE-së për Kujdesin dhe Strategjinë e BE-së për Barazinë Gjinore. Këto angazhime bëhen më funksionale më tej nëpërmjet përpjekjeve të OKB-së për adresimin e çështjeve të kujdesit, në përputhje edhe me Dokumentin e Politikave të Sistemit të OKB-së "Transformimi i Sistemeve të Kujdesit" (2024), si dhe korniza të tjera si: Korniza e UN Women për Punën e Kujdesit të Paguar dhe të Papaguar. Agjenda udhëhiqet nga ky vizion: "Kujdesi është në qendër të ekonomive të lulëzuara, të qëndrueshme dhe të drejta; ku kujdesi shikohet si një e mirë publike dhe si një punë e kualifikuar dhe thelbësore, e cila është vendimtare për mirëqenien shoqërore dhe ekonomike; dhe ku kujdesi njihet si bazë për pjesëmarrje

dhe trajtim të barabartë në shoqëri dhe nuk reduktohet në një mall, një zgjedhje personale apo një detyrim familjar".

Jemi të kënaqur që Shqipëria ka konfirmuar mbështetjen e saj për zbatimin e këtij dokumenti, i cili do të kërkojë **veprime të koordinuara ndërmjet sektorëve dhe aktorëve të ndryshëm,** për të kaluar nga qasjet e fragmentarizuara të kujdesit drejt sistemeve të kujdesit me ndjeshmëri gjinore dhe të përqendruara në të drejtat e njeriut.

Ky studim është hapi i parë në këtë drejtim. Ai zbaton për herë të parë në Shqipëri **instrumentin e politikave të UN Women dhe ILO-s** dhe ofron një pasqyrë të mangësive në mbulimin e shërbimeve, kostove të vlerësuara dhe kthimeve nga këto investime. Gjithashtu, ai analizon vlerën e parashikuar të punës së papaguar të kujdesit që bëhet nga gratë dhe burrat në Shqipëri dhe kontributin e tyre ekuivalent në PBB. Në vija të përgjithshme, studimi është një hap i rëndësishëm dhe domethënës drejt adresimit të ekonomisë së kujdesit si një faktor pengues që aktualisht kufizon fuqizimin e plotë ekonomik të grave dhe pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës, si dhe një sektor ekonomik me potencial të madh transformues. Investimi në kujdes nënkupton nxitjen e ndryshimeve në jetën shoqërore dhe ekonomike të të gjitha grave dhe përshpejtimin e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë.

UN Women shpreh mirënjohjen për mbështetjen e çmuar të shumë aktorëve për hartimin e këtij studimi, veçanërisht për kontributin e rëndësishëm të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar dhe SIDA-s, si dhe të të gjithë partnerëve kombëtarë përkatës.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky studim synon të vlerësojë mangësitë ekzistuese në mbulimin me shërbime kujdesi në Shqipëri krahasuar me objektivat kryesore të BE-së dhe ato ndërkombëtare, për dy grupe kryesore të synuara: fëmijët dhe të moshuarit. Studimi tregon se gratë në Shqipëri vazhdojnë të kryejnë pjesën më të madhe të të gjitha formave të punës së kujdesit dhe argumenton se ky është një faktor pengues për pjesëmarrjen e tyre aktive në tregun e punës. Studimi përdor instrumentin e politikave të UN Women - ILO për të vlerësuar mangësitë në mbulimin e Shërbimeve të Kujdesit dhe të Edukimit në Fëmijërinë e Hershme (ECCE) dhe të Kujdesit Afatgjatë, duke vlerësuar koston e parashikuar për mbylljen e këtyre boshllëqeve dhe duke ofruar një vlerësim të përfitimeve nga investimet, të cilat do të gjeneroheshin nëpërmjet krijimit të drejtëpërdrejtëtë vendeve të punës.

Analiza identifikon mungesa të konsiderueshme në ofrimin e shërbimeve të kujdesit. Në fushën e Kujdesit dhe Edukimit në Fëmijërinë e Hershme (ECCE), afërsisht 39,029 fëmijë të moshës 0-6 vjeç nuk marrin shërbime në raport me objektivat e BE-së dhe ato ndërkombëtare. Në kujdesin afatgjatë, rreth 37,849 persona të moshuar nuk kanë akses në shërbime formale të përkujdesit. Në përgjithësi, nevoja totale e paplotësuar në fushat e ECCE-së dhe Kujdesit Afatgjatë (LTC) arrin në rreth 76,878 individë. Studimi vlerëson se mbyllja e këtyre boshllëqeve në mbulimin me shërbime do të kërkonte një investim prej afërsisht 13.2 miliardë lekësh, ekuivalente me rreth 0.56% të PBB-së. Pavarësisht shkallës relativisht të moderuar të investimeve, **gjetjet tregojnë përfitime të konsiderueshme ekonomike dhe sociale: investimet në ekonominë e përkujdesit mund të gjenerojnë rreth 11,869 vende të reja pune të drejtpërdrejta, në 75% të të cilave do të angazhoheshin gra.** Përveç kësaj, zgjerimi i shërbimeve të kujdesit do të rriste masën e pagave, do të stimulonte kërkesën e brendshme dhe do të gjeneronte të ardhura shtesë nga taksat, si dhe kontribute të detyrueshme në sigurime shoqërore dhe pensione. Efektet pozitive fiskale vlerësohen në afërsisht 0.20% të PBB-së, duke mbuluar rreth 36% të kostove të përgjithshme të investimit.

Përtej efekteve të tij në punësim, studimi nxjerr në pah kontributin e konsiderueshëm të fshehur ekonomik të kujdesit të papaguar dhe punës shtëpiake në strukturën ekonomike dhe shoqërore të Shqipërisë. Puna e papaguar e kujdesit vlerësohet të jetë ekuivalente me

më shumë se 1.1 milion punonjës me kohë të plotë, pothuajse e barabartë me totalin e punësimit zyrtar në vend. Vlera e përllogaritur e saj arrin deri në 40.7% të PBB-së, në të cilën 34.1% kontribuojnë gratë, duke demonstruar rolin qendror, por kryesisht të padukshëm, të punës së papaguar të kujdesit në mbështetjen e ekonomisë dhe shoqërisë.

Gjetjet tregojnë se investimi në ekonominë e kujdesit nuk duhet të shikohet vetëm si një shpenzim social, por edhe si një investim strategjik social dhe ekonomik që gjeneron përfitime të shumta. Zgjerimi i aksesit në shërbime cilësore të kujdesit për fëmijët dhe kujdesit afatgjatë do të përmirësonte mirëqenien dhe cilësinë e jetës së fëmijëve, të moshuarve dhe familjeve, duke mbështetur njëkohësisht zhvillimin e kapitalit njerëzor, duke rritur pjesëmarrjen e grave në tregun e punës, duke reduktuar pabarazitë gjinore dhe duke nxitur një rritje ekonomike më gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Në tërësinë e tij, studimi ofron dëshmi se investimi në ekonominë e kujdesit përfaqëson një nga mundësitë me përfitimin më të lartë për avancimin e barazisë gjinore, krijimin e vendeve të punës, mbrojtjen sociale dhe qëndrueshmërinë ekonomike afatgjatë në Shqipëri. Së fundmi, studimi bën thirrje gjithashtu për zbatimin e kornizave ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe ekonominë e kujdesit në kontekstin shqiptar, konkretisht kornizave 6R, në mënyrë që Shqipëria të veprojë në përputhje me detyrimet kombëtare dhe ato ndërkombëtare, si dhe t'i përmbushë ato, ashtu siç janë përcaktuar në Strategjinë e BE-së për Kujdesin, Strategjinë e Bashkimit Europian për Barazinë Gjinore, Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Ligjin për Barazinë Gjinore.

PËRMBAJTJA

Falënderime 4
Lista e Shkurtesave 5
Parathënie 6
Përmbledhje Ekzekutive 8
Lista e Tabelave 11
Lista e Grafikëve 11

I. HYRJE 12

II. ANALIZA E NDRYSHIMEVE DEMOGRAFIKE, SI DHE E NEVOJAVE DHE E MANGËSIVE NË SHËRBIMET E KUJDESIT NË SHQIPËRI 15

2.1 Sfidat demografike dhe të kujdesit në Shqipëri 15
2.2 Shërbimet e kujdesit në Fëmijërinë e Hershme dhe Kujdesi Afatgjatë në Shqipëri 17
2.3 Kontributi i studimit në prioritetet kombëtare 19

III. KUADRI KONCEPTUAL, QASJA ANALITIKE DHE METODOLOGJIA 22

3.1 Kuadri konceptual: Ekonomia e Përkujdesit 22
3.2 Përkufizime kryesore 23
3.3 Qasja analitike dhe metodologjia 24
3.4 Burimet e të dhënave 30
3.5 Kufizimet 31

IV. GJETJET KRYESORE NGA ANALIZA KOSTO-PËRFITIM 33

4.1 Mangësitë në mbulimin e shërbimeve dhe shpenzimet e nevojshme për shërbimet në ECCE 33
4.2 Mangësitë në mbulimin e shërbimeve dhe shpenzimet e nevojshme për shërbimet e Kujdesit Afatgjatë 35
4.3 Ndikimi i investimeve në Kujdesin dhe Edukimin në Fëmijërinë e Hershme dhe Kujdesin Afatgjatë për krijimin e vendeve të punës 37
4.4 Përllogaritja e ekuivalentit të punonjësve me kohë të plotë në punë të papaguar 40
4.5 Përllogaritja e ekuivalentit të punonjësve me kohë të plotë sipas llojit të punës së papaguar të kujdesit 46
4.6 Kontributi i Ekonomisë së Përkujdesit në PBB në Shqipëri 49

V. PËRFUNDIME 52

VI. REKOMANDIME 54

VII. SHTOJCA 1: TABELAT E REZULTATEVE NGA USHTRIMI PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË PAPAGUAR TË KUJDESIT 57

VIII. REFERENCAT 62

LISTA E TABELAVE

TABELA 1 — Mungesat në mbulim dhe kostot në sektorët e kujdesit 36

TABELA 2 — Ndikimi i drejtpërdrejtë në punësim i investimeve në kujdesin social (numri i vendeve të reja të punës) 38

TABELA 3 — Ndikimi i investimeve në kujdesin social në masën e pagave, të ardhurave dhe kontributet në sigurimet shoqërore 39

TABELA 4 — Koha mesatare (në orë dhe minuta) e shpenzuar në veprimtarinë kryesore sipas gjinisë, popullsisë 10 vjeç e lart dhe 15-64 vjeç (të gjitha ditët e javës) 42

TABELA 5 — Ekuivalenti i punonjësve me kohë të plotë në punë të papaguar kujdesi sipas gjinisë 58

TABELA 6 — Kontributi i punës së papaguar në PBB dhe në PBB të zgjeruar sipas ekuivalentit të punonjësve me kohë të plotë dhe vlerave të ndryshme të pagave, popullsia 10+ vjeç 59

TABELA 7 — Kontributi i punës së papaguar në PBB dhe në pbb të zgjeruar sipas ekuivalentit të numrit të punonjësve me kohë të plotë dhe vlerave të ndryshme të pagave, popullsia 15-64 vjeç 61

LISTA E GRAFIKËVE

GRAFIKU 1 — Ekuivalenti i punonjësve me kohë të plotë në punë të papaguar (të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë) 46

GRAFIKU 2 — Ekuivalenti i punonjësve me kohë të plotë sipas llojit të punës së papaguar të kujdesit 48

GRAFIKU 3 — Kontributi i punës së papaguar në PBB (në përqindje) 50

I. HYRJE

Nevoja për të njohur dhe matur punën e papaguar të kujdesit, kontributin e saj në ekonomi dhe potencialin për krijimin e vendeve të punës është e njohur mjaft mirë. Gratë preken në mënyrë disproporcionale nga përgjegjësitë e punës së papaguar të kujdesit, të përqendruara kryesisht në kujdesin për fëmijët dhe për të moshuarit. Në mungesë të shërbimeve të mjaftueshme të kujdesit, gratë nuk arrijnë të përfitojnë nga investimet e tyre në formimin e kapitalit njerëzor dhe madje largohen nga tregu i punës, duke çuar në përkeqësim të rezultateve në tregun e punës, paga më të ulëta dhe pasiguri në moshën e tretë. Prandaj, ofrimi i shërbimeve të arritshme dhe të përballueshme të kujdesit është thelbësor për mbështetjen e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore, në aktivitete gjeneruese të të ardhurave dhe për fuqizimin e tyre ekonomik.

Nevoja për të rritur investimet në ekonominë e përkujdesit po njihet gjithnjë e më shumë si një prioritet i rëndësishëm i politikave për barazinë gjinore, krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin ekonomik. Kjo përfshin zgjerimin dhe përmirësimin e sektorëve të shërbimeve të kujdesit, siç janë kujdesi dhe edukimi në fëmijërinë e hershme, si dhe kujdesi afatgjatë për të moshuarit[1]. Në këtë drejtim, ekonomia e përkujdesit meriton vëmendje të veçantë në kuadër të zbatimit të angazhimeve ekzistuese kombëtare dhe ndërkombëtare[2] për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore në të gjitha fushat e jetës. Në nivel global, Rezoluta e ILO-s e vitit 2024 mbi Punën e denjë dhe Ekonominë e Përkujdesit[3], si dhe Korniza për Punë të Denjë Kujdesi, inkurajon qeveritë, organizatat e punëdhënësve dhe të punëmarrësve që të hartojnë dhe zbatojnë politika dhe sisteme të integruara kujdesi, të mbështetura në Kornizën 5R për Punë të Denjë Kujdesi. Ajo gjithashtu kërkon politika mbështetëse të kujdesit në vendin e punës, të cilat marrin parasysh nevojat e të gjithë punonjësve me përgjegjësi kujdesi. Për më tepër, Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) 5.4 kërkon njohjen, vlerësimin dhe reduktimin e punës së papaguar të kujdesit dhe punës në shtëpi nëpërmjet ofrimit të shërbimeve publike, infrastrukturës dhe politikave të mbrojtjes sociale, si dhe nxitjen e përgjegjësive të përbashkëta brenda familjes dhe bërthamës familjare. Ky është një moment i përshtatshëm, ndërkohë që Shqipëria përparon në rrugën e saj drejt integrimit në BE, duke krijuar mundësi të reja për t'u përshtatur me prioritetet e Bashkimit Europian (BE) në fushën e çështjeve sociale dhe barazisë gjinore, duke përfshirë edhe Strategjinë e re të BE-së për Barazinë Gjinore 2026–2030. Disa nga prioritetet e saj

1 OKB (2024b). Transformimi i Sistemeve të Kujdesit: Dokument Politik i OKB-së: https://unsdg.un.org/resources/transforming-care-systems-un-system-policy-paper

2 "Rezolutë në lidhje me punën e denjë dhe ekonominë e përkujdesit." ILO (2024). https://www.ilo.org/sites/default/files/2024-07/ILC112-Resolution%20V-%7BRELMEETINGS-240620-001%7D-Web-EN_0.pdf

3 Korniza 5R trajtohet në mënyrë të detajuar në seksionin 4.

kryesore lidhen drejtpërdrejt me këtë punë, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me balancën punë - jetë dhe ekonominë e përkujdesit, fuqizimin ekonomik të grave, si dhe fokusin e vazhdueshëm në reduktimin e hendekut gjinor në paga dhe pensione. Në nivel rajonal, Strategjia Europiane për Kujdesin[4] i jep përparësi zgjerimit të shërbimeve të kujdesit për të përmbushur nevojat aktuale dhe të ardhshme për kujdes, duke përmirësuar njëkohësisht cilësinë, përballueshmërinë dhe aksesueshmërinë e tyre. Në këtë mënyrë, ajo synon të heqë pengesat për gratë që hyjnë në tregun e punës duke rritur ofrimin e shërbimeve të kujdesit për fëmijët. Ajo gjithashtu synon të forcojë mbrojtjen sociale për kujdesin afatgjatë dhe të përmirësojë përshtatshmërinë, disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë e shërbimeve të kujdesit afatgjatë. Përveç kësaj, Strategjia e BE-së përcakton objektiva të qarta mbulimi për Edukimin dhe Kujdesin në Fëmijërinë e Hershme (ECCE), ku kërkohet që Shtetet Anëtare të ofrojnë shërbime për 50% të popullsisë së moshës 0-3 vjeç dhe 100% për fëmijët e moshës 4-6 vjeç (niveli i arsimit parashkollor).

Në nivel kombëtar, Shqipëria e ka njohur zyrtarisht rëndësinë e ekonomisë së përkujdesit në strategji të ndryshme kombëtare. Veçanërisht, zhvillimi më i fundit përfshin njohjen e punës së papaguar në Ligjin e ri për Barazinë Gjinore[5], duke riafirmuar angazhimin e vendit për të përshpejtuar barazinë gjinore midis burrave dhe grave, të ndërmarrë në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030[6] në kuadër të qëllimit të saj të parë strategjik përqendrohet në zbatimin e kornizave ligjore dhe politikave të përmirësuara që mundësojnë ndarjen e barabartë të punës së papaguar shtëpiake dhe të kujdesit ndërmjet grave dhe burrave, vajzave dhe djemve të rinj; rritjen e aksesit të grave dhe vajzave, në gjithë diversitetin e tyre, në shërbimet dhe produktet financiare, si dhe në burimet prodhuese; si dhe në reduktimin e pengesave që i mbajnë gratë dhe vajzat larg tregut të punës dhe rritjen e aksesit në punë të denjë.

Për më tepër, Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale (SKMS) 2024–2030 njeh gjithashtu nevojën për adresimin e ekonomisë së përkujdesit si një fushë mbështetëse për reformat në politikat sociale dhe ekonomike. Strategjia mbështetet në legjislacionin dhe politikat sociale të BE-së, si dhe në Shtyllën e BE-së për të Drejtat Sociale, si pjesë e procesit të vazhdueshëm të integrimit europian. SKMS 2024-2030 paraqet vizionin e "mbrojtjes sociale në një mjedis mundësues dhe fuqizues për çdo individ në nevojë, duke siguruar një jetë dinjitoze gjatë gjithë ciklit jetësor". Përveç kësaj, strategjia përqendrohet

4 Komisioni Europian (2022). "Komunikim nga Komisioni drejtuar Parlamentit Europian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social Europian dhe Komitetit të Rajoneve mbi Strategjinë Europiane të Kujdesit."

5 Qeveria e Shqipërisë (2025). "Ligji Nr. 64/2025 Për Barazinë Gjinore." https://qbz.gov.al/eli/fz/2025/229/b69d770a-44f9-4a06-990c-64b22c7f1d09;q=ligji%20per%20barazine%20gjinore%202025

6 Ministria e Shëndetësisë dhe e Mirëqënies Sociale (2021). Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2021–2030. Fletorja Zyrtare, VKM Nr. 400, 30 Qershor 2021.

në i) reduktimin e varfërisë për familjet në nevojë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet skemave financiare të përshtatshme, të strukturuara mirë, transparente dhe të përgjegjshme ndaj riskut; dhe ii) zgjerimin e shërbimeve sociale të integruara dhe cilësore, si dhe avancimin e deinstitucionalizimit në partneritet me autoritetet vendore dhe aktorët e tjerë. Për më tepër, strategjia përfshin masa të përgjegjshme ndaj tronditjeve, duke forcuar lidhjet me tregun e punës, duke zgjeruar mbulimin, duke përmirësuar saktësinë, si dhe duke mbështetur decentralizimin dhe deinstitucionalizimin e kujdesit rezidencial.

Investimi në ekonominë e përkujdesit në Shqipëri është, për rrjedhojë, strategjik, pasi ai avancon drejtpërdrejt prioritetet kryesore kombëtare për barazinë gjinore, punësimin e denjë dhe mbrojtjen sociale, duke mbështetur njëkohësisht planet për anëtarësimin në BE.

II. ANALIZA E NDRYSHIMEVE DEMOGRAFIKE, SI DHE E NEVOJAVE DHE E MANGËSIVE NË SHËRBIMET E KUJDESIT NË SHQIPËRI

2.1 Sfidat demografike dhe të kujdesit në Shqipëri

Ashtu si shumë vende të tjera në botë, duke përfshirë edhe ato të Bashkimit Europian dhe Ballkanit Perëndimor, Shqipëria po përballet me sfida të vazhdueshme në ofrimin e shërbimeve të kujdesit që janë të aksesueshme, të përballueshme dhe cilësore gjatë gjithë jetës. Nevoja për të investuar në shërbimet e kujdesit është e lidhur ngushtë me transformimin demografik të Shqipërisë. Censi i vitit 2023 konfirmon një rënie të vazhdueshme të popullsisë dhe plakje të saj, të nxitura nga nivelet e lindshmërisë nën pragun e zëvendësimit të popullsisë, migracioni neto negativ dhe rritja e peshës së personave të moshuar në popullsi. Popullsia e Shqipërisë ra në 2.4 milionë banorë në vitin 2023[7], rreth 420,000 më pak se në vitin 2011. Në të njëjtën kohë, numri i personave të moshës 65 vjeç e lart u rrit nga 317,585 në vitin 2011 në 473,104 në vitin 2023, duke shënuar një rritje prej më shumë se 155,000 personash. Këto shifra shënojnë një pikë kthese vendimtare në strukturën demografike të Shqipërisë: personat e moshuar janë tashmë e vetmja grupmoshë në rritje në një popullsi që, në tërësi, është në tkurrje. Raporti i varësisë së të moshuarve, i cili mat numrin e personave të moshës 65 vjeç e lart për çdo 100 persona në moshë pune, u rrit nga 11.9 në vitin 2001 në 16.7 në vitin 2011 dhe arriti në 30.4 në vitin 2023[8]. Për herë të parë në historinë demografike të Shqipërisë, raporti i varësisë së të moshuarve tejkaloi raportin e varësisë së të rinjve, i cili ra nga 46.4 në 24.0 gjatë së njëjtës periudhë. Në të njëjtën kohë, lindshmëria ka rënë ndjeshëm gjatë dekadave të fundit, nga 2.31 në vitin 2001 në 1.65 në vitin 2011 dhe 1.21 në vitin 2022. Emigracioni mbetet një nga faktorët përcaktues të ndryshimeve demografike në Shqipëri dhe një nxitës kryesor i rënies së popullsisë. Numri i emigrantëve u rrit nga 38,703 në

7 INSTAT. "Censi i vitit 2023."
https://www.instat.gov.al/al/temat/censet/censet-e-popullsis%C3%AB-dhe-banesave/#tab2

8 INSTAT. "Censi i vitit 2023."
https://www.instat.gov.al/al/temat/censet/censet-e-popullsis%C3%AB-dhe-banesave/#tab2

vitin 2018 në 46,460 në vitin 2022[9], ndërsa migracioni negativ neto u thellua nga -15,030 në -32,497 gjatë së njëjtës periudhë. Arsimi cilësor për fëmijët dhe pakënaqësia në lidhje me sigurimet shoqërore, kujdesin shëndetësor, shërbimin civil, sistemin e drejtësisë dhe institucionet politike renditen ndër faktorët kryesorë që nxisin migracionin[10].

Këto prirje demografike po rrisin nevojat për kujdes, ndërkohë që, në të njëjtën kohë, po zvogëlojnë popullsinë në moshë pune që mund të ofrojë dhe të financojë shërbimet e kujdesit. Në këtë kontekst, shërbimet e kujdesit nuk janë vetëm një çështje e mbrojtjes sociale, por edhe një komponent thelbësor i qëndrueshmërisë ekonomike dhe demografike të Shqipërisë.

Roli dhe rëndësia e ekonomisë së përkujdesit shpesh nënvlerësohen, pasi një pjesë e madhe e kujdesit kryhet si punë e papaguar brenda familjeve dhe mbetet e padukshme në statistikat ekonomike standarde. Kjo mungesë e dukshmërisë kufizon ndikimin e saj në debatet për politikat publike dhe kufizon investimet në infrastrukturën dhe shërbimet e kujdesit. Prandaj, njohja, reduktimi dhe rishpërndarja e punës së papaguar të kujdesit janë thelbësore për fuqizimin ekonomik të grave, rritjen e aksesit të tyre në punësim të paguar dhe krijimin e vendeve të punës në sektorët e ekonomisë të kujdesit të paguar.

Mbulimi aktual i shërbimeve mbetet i kufizuar. Sipas Censit të vitit 2023, vetëm 37% e fëmijëve të moshës 0-3 vjeç ndjekin çerdhe, duke lënë pothuajse dy të tretat e fëmijëve të vegjël jashtë shërbimeve të kujdesit për fëmijë. Edhe mundësitë e kujdesit për personat e moshuar janë po aq të kufizuara. Shërbimet e kujdesit në shtëpi janë kryesisht të padisponueshme dhe shumica e qendrave jo-publike të kujdesit janë të orientuara kryesisht drejt personave me aftësi ndryshe dhe jo drejt personave të moshuar. Sipas vlerësimeve të ILO-s, rreth 91,000 persona të moshuar, ose 21.6% e atyre të moshës 65 vjeç e lart, kanë nevojë për kujdes afatgjatë, megjithatë më pak se 2% marrin mbështetje formale[11].

Këto mungesa tregojnë se Shqipëria po përballet me një sfidë të dyfishtë në fushën e kujdesit: ofrim të pamjaftueshëm të shërbimeve të kujdesit për fëmijët e vegjël dhe shërbime të kufizuara të kujdesit afatgjatë për të moshuarit. Si rezultat, familjet, dhe veçanërisht gratë, vazhdojnë të mbajnë një pjesë të madhe të përgjegjësive të papaguara të kujdesit kur shërbimet formale mungojnë, janë të papërballueshme ose me cilësi të pamjaftueshme.

9 INSTAT (2023). "Statistikat e Migracionit."

10 Gëdeshi, I., dhe King, R. (2020). AZILKËRKUESIT SHQIPTARË TË KTHYER: RIINTEGRIM APO RIEMIGRIM?

11 ILO (2022). "Kujdesi Afatgjatë për të Moshuarit në Shqipëri: Sfidat dhe Çështjet Kryesore të Politikave." Budapest: ILO. https://www.ilo.org/sites/default/files/wcmsp5/groups/public/@europe/@ro-geneva/@sro-budapest/documents/publication/wcms_846063.pdf.

Në këtë kontekst, investimi në ekonominë e përkujdesit është jetik për Shqipërinë. Zgjerimi i aksesit në shërbime cilësore dhe të përballueshme të edukimit dhe kujdesit në fëmijërinë e hershme (ECCE), si dhe të kujdesit afatgjatë për personat e moshuar përbën si një prioritet social, ashtu edhe një domosdoshmëri ekonomike, veçanërisht duke pasur parasysh plakjen e popullsisë, emigracionin jashtë vendit dhe tkurrjen e fuqisë punëtore. Prandaj, shpenzimet publike për shërbimet e kujdesit duhet të kuptohen jo vetëm si shpenzime sociale, por si një investim strategjik me mundësi përfitimesh në punësim, barazi gjinore, mbrojtje sociale dhe qëndrueshmëri ekonomike afatgjatë.

Në këtë kuadër, objektivi kryesor i këtij studimi është të vlerësojë dhe të llogarisë koston e mangësive në mbulimin e dy llojeve të shërbimeve të kujdesit: i) kujdesi dhe edukimi në fëmijërinë e hershme për fëmijët e moshës 0–3 dhe 4–6 vjeç; dhe ii) kujdesi afatgjatë për personat e moshuar. Studimi gjithashtu vlerëson përfitimet e mundshme ekonomike nga rritja e investimeve në shërbimet e kujdesit, me vëmendje të veçantë në krijimin e drejtpërdrejtë të vendeve të punës[12], zgjerimin e masës së pagave, rritjen e të ardhurave tatimore dhe kontributeve për pension.

2.2 Shërbimet e kujdesit në Fëmijërinë e Hershme dhe Kujdesi Afatgjatë në Shqipëri

Kujdesi dhe Edukimi në Fëmijërinë e Hershme (ECCE)

Që nga viti 2016, Kujdesi dhe Edukimi në Fëmijërinë e Hershme (ECCE)[13] në Shqipëri është decentralizuar në nivel të qeverisjes vendore, duke i bërë bashkitë përgjegjëse për menaxhimin, administrimin dhe financimin e tij. Financimi për shërbimet ECCE kryesisht vjen nga transfertat e qeverisë qendrore[14], por këto alokime konsiderohen gjerësisht të pamjaftueshme, duke i lënë bashkitë të varura nga buxheti kombëtar. Megjithëse fondi i përgjithshëm është rritur që nga decentralizimi, ai nuk ka ecur në të njëjtin ritëm me rritjen e PBB-së apo me buxhetet e përgjithshme vendore, duke rezultuar në mungesë të vazhdueshme të fondeve dhe pabarazi në cilësinë e ofrimit të shërbimeve ndërmjet bashkive. Në tërësi, arsimi parashkollor përbën rreth 11–12% të shpenzimeve të bashkive për arsimin ECCE dhe rreth 16% të shpenzimeve për arsimin bazë. Në vitin 2023, shpenzimet për ECCE arritën në 20.5% të të ardhurave të bashkive, duke shënuar një rënie

12 Vlerësimi i krijimit të tërthortë të vendeve të punës, gjë që kërkon përdorimin e tabelave input-output, është jashtë objektit të këtij studimi. Punësimi i drejtpërdrejtë përfshin vendet e reja të punës në sektorët e kujdesit që krijohen si rezultat i drejtpërdrejtë i rritjes së shpenzimeve për zgjerimin e shërbimeve të kujdesit, duke përfshirë si punonjësit e kujdesit, ashtu edhe punonjësit jo të kujdesit të punësuar në këta sektorë.

13 UNICEF dhe EuroPartners Development (2023). "Opsionet e politikave për financimin e edukimit në fëmijërinë e hershme në Shqipëri."

14 40% e financimit bazohet në numrin e mësuesve dhe 60% e financimit bazohet në numrin e nxënësve.

prej 1.9 pikësh përqindjeje krahasuar me vitin 2017. Shpenzimet ndryshojnë ndjeshëm ndërmjet bashkive, me pabarazi si në investimin për çdo fëmijë ashtu edhe në aksesin në shërbime cilësore. Shpenzimet për ECCE në Shqipëri përbëjnë vetëm 0.29% të PBB-së, dukshëm më poshtë se standardet e Bashkimit Europian dhe OECD-së për edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme, të cilat zakonisht vlerësohen në rreth 0.6–0.8% të PBB-së.[15] Ato gjithashtu përfaqësojnë rreth 0.85% të shpenzimeve të përgjithshme publike vjetore, krahasuar me 1.5% në BE. Për çdo fëmijë, Shqipëria shpenzon rreth 719 dollarë në vit, një shifër që është dukshëm më e ulët se në vendet e OECD-së[16]. Numri i nxënësve në klasë është relativisht i lartë, çka tregon presion mbi burimet dhe cilësinë e shërbimeve. Praktikat e buxhetimit shpesh e kombinojnë ECCE me arsimin bazë, duke reduktuar transparencën në alokime dhe shpenzime. Në tërësi, pavarësisht reformave të decentralizimit, ECCE mbetet i pafinancuar sa duhet, me ndikime të rëndësishme në cilësinë dhe mbulimin e shërbimeve. Ekziston një nevojë thelbësore për rritjen e financimit të qëndrueshëm publik.

Kujdesi afatgjatë për personat e moshuar

Kujdesi afatgjatë[17] (LTC) në Shqipëri bazohet kryesisht tek familja; 95% e të moshuarve mbështeten tek të afërmit për kujdes, ndërsa vetëm 5% marrin kujdes nga ofrues jo-familjarë dhe vetëm 2% marrin shërbime të paguara, kryesisht të financuara nga shteti. Pavarësisht kësaj varësie, 13% e personave të moshuar në nevojë nuk marrin asnjë shërbim kujdesi, duke nxjerrë në pah mungesa të konsiderueshme në mbulimin e shërbimeve të kujdesit. Shërbimet formale të kujdesit mbeten të kufizuara dhe të shpërndara në mënyrë të pabarabartë në të gjithë vendin. Shqipëria ka vetëm 23 institucione rezidenciale të kujdesit, të cilat u shërbejnë rreth 705 personave të moshuar. Kujdesi rezidencial mbulon më pak se 1% të personave të moshës 65+ vjeç , ndërsa 36 qendra komunitare ditore mbështesin rreth 3,000 përfitues. Shërbimet me bazë në komunitet janë të pamjaftueshme; pothuajse gjysma e bashkive nuk ofrojnë mbështetje të tilla, duke ndikuar negativisht, në mënyrë të veçantë në zonat rurale. Sektori kufizohet edhe më tej nga shërbimet e specializuara të pazhvilluara sa duhet dhe sfidat e vazhdueshme financiare. Shumë institucione raportojnë fonde të pamjaftueshme për zgjerimin e shërbimeve, përmirësimin e infrastrukturës apo ofrimin e pagave konkurruese. Fuqia punëtore në kujdesin social formal përbëhet nga rreth 3,700 punonjës, shumica e të cilëve janë të punësuar në institucione dhe jo në nivel bashkie. Sektori përbëhet kryesisht nga gra (81%) dhe përballet me mungesa të vazhdueshme si në staf ashtu edhe në formim profesional, duke ndikuar në cilësinë e përgjithshme dhe në qëndrueshmërinë e ofrimit të shërbimeve të kujdesit.

15 Eurostat (2022) https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/educ_uoe_fine06__custom_21704309/default/table

16 Vendet e OECD-së shpenzojnë mesatarisht rreth 11,735 USD për fëmijë në vit për arsimin parashkollor.

17 UNDP (2025). "Plakja në Shqipëri: Vështrime mbi Kujdesin Afatgjatë për të Moshuarit."

2.3 Kontributi i studimit në prioritetet kombëtare

Ky studim mbështet Qeverinë e Shqipërisë në përcaktimin e përparësive për shpenzimet nga këndvështrimi i barazisë gjinore dhe rritjes gjithëpërfshirëse. Ai u mundëson politikëbërësve të njohin potencialin e investimeve në ekonominë e përkujdesit për të çuar përpara prioritetet e zhvillimit, për të forcuar kapacitetet kombëtare dhe për të përafruar politikat e kujdesit me standardet ndërkombëtare dhe objektivat e BE-së.

Duke ofruar të dhëna mbi kostot dhe përfitimet e zgjerimit të shërbimeve të kujdesit, studimi nxjerr në pah potencialin e sektorit të kujdesit për të nxitur krijimin e vendeve të punës, për të rritur pjesëmarrjen e grave në tregun e punës dhe për të ndihmuar në adresimin e sfidave demografike, duke përfshirë plakjen e popullsisë, mungesën e fuqisë punëtore dhe emigracionin jashtë vendit.

Për më tepër, prova të shumta tregojnë se aksesi në ECCE me cilësi të lartë ofron përfitime të konsiderueshme afatgjata për fëmijët. Ai mbështet zhvillimin më të fortë të aftësive, përmirëson frekuentimin e shkollës, rrit regjistrimin në arsimin e lartë dhe forcon aftësitë teknike. Këto përfitime janë veçanërisht të rëndësishme për fëmijët nga familje të varfra dhe të disavantazhuara, duke kontribuar në rritjen e produktivitetit në të ardhmen dhe në zhvillimin më të gjerë shoqëror.

Ky studim mund të mbështesë gjithashtu angazhimet strategjike kombëtare si:

1. Zbatimi i ligjit të ri për Barazinë Gjinore në Shqipëri (LBGJ): Ai mbështet zbatimin e dispozitave që lidhen me njohjen, matjen dhe marrjen në konsideratë të politikave të kujdesit të papaguar dhe punës në shtëpi, duke mbështetur hartimin e politikave të bazuara në të dhëna.

2. Zbatimi i NSSP-së: Studimi mbështet zbatimin me sukses të NSSP-së, duke u përqendruar në rëndësinë e ekonomisë së përkujdesit dhe të ofrimit të shërbimeve të kujdesit për të mbështetur dhe zgjeruar mbrojtjen sociale. NSSP-ja identifikon shërbimet shoqërore, duke përfshirë kujdesin, si një gur themeli për të mundësuar një jetë dinjitoze gjatë gjithë ciklit të jetës. Të dhënat e këtij studimi mbështetin zgjerimin e shërbimeve të integruara dhe cilësore të kujdesit, me bazë në komunitet, në përputhje me qëllimet e deinstitucionalizimit. Duke lidhur ofrimin e kujdesit me pjesëmarrjen në tregun e punës, studimi ofron prova që forcojnë objektivat e NSSP-së për uljen e varfërisë, mbështetjen e personave të moshuar dhe rritjen e qëndrueshmërisë ndaj goditjeve nëpërmjet skemave më gjithëpërfshirëse të mbrojtjes sociale.

3. Studimi mbështet përpjekjet e vazhdueshme në kuadër të Kapitullit 19 të procesit të anëtarësimit në BE për Politikat Sociale dhe të Punësimit, duke i përafruar me politikat e punësimit, përfshirjes sociale, mbrojtjes sociale dhe mundësive të barabarta. Politikat e kujdesit janë thelbësore për prioritetet e investimeve sociale të BE-së, veçanërisht në fushat e punësimit, mbrojtjes sociale, mundësive të barabarta dhe gjithëpërfshirjes sociale. Forcimi i shërbimeve të kujdesit e përafron Shqipërinë me Strategjinë e Kujdesit të BE-së dhe Shtyllën Europiane të të Drejtave Sociale, të cilat theksojnë kujdesin e përballueshëm për fëmijët, kujdesin afatgjatë dhe barazinë gjinore në punë dhe jetë. Zgjerimi i ofrimit të kujdesit për fëmijët dhe të moshuarit kontribuon drejtpërdrejt në aktivizimin e tregut të punës, veçanërisht të grave, duke përmirësuar njëkohësisht përshtatshmërinë dhe mbulimin e mbrojtjes sociale në përputhje me kërkesat e legjislacionit të BE-së.

4. Studimi mbështet përafrimin me objektivat ndërkombëtare të përcaktuara në Strategjinë e Kujdesit të BE-së: arritjen e një shkalle regjistrimi prej 50% në edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme për fëmijët nën moshën 3 vjeç, në përputhje me objektivat e BE-së. Mbyllja e këtij boshllëku jo vetëm që do të përmirësojë zhvillimin në fëmijërinë e hershme, por edhe do të çlirojë gratë nga një përgjegjësi disproporcionale e punës së papaguar, duke mundësuar rritjen e pjesëmarrjes së tyre në tregun e punës. Forcimi dhe zgjerimi i aksesit, përshtatshmërisë dhe përballueshmërisë së kujdesit afatgjatë për personat e moshuar në varësi janë mjaft thelbësorë. Prandaj, forcimi i kujdesit në shtëpi dhe atij me bazë në komunitet është urgjent për të parandaluar përjashtimin dhe për të siguruar moshimin dinjitoz.

5. Angazhimet kombëtare ndaj OZHQ 5.4: Forcimi i angazhimit kombëtar ndaj OZHQ 5.4, i cili kërkon në mënyrë specifike njohjen, reduktimin dhe rishpërndarjen e punës së papaguar të kujdesit nëpërmjet shërbimeve, infrastrukturës dhe ndarjes së përgjegjësive. Zgjerimi i shërbimeve të kujdesit kontribuon gjithashtu në objektiva të tjerë të zhvillimit të qëndrueshëm, duke përfshirë pa varfëri (OZHQ 1), punë dinjitoze dhe rritje ekonomike (OZHQ 8), si dhe zvogëlimi i pabarazive (OZHQ 10).

Ky studim plotëson hulumtimet ekzistuese mbi ECCE, kujdesin afatgjatë dhe ekonominë e përkujdesit të kryera nga agjencitë e OKB-së në Shqipëri, duke përfshirë UNICEF-in dhe UNDP-në, si dhe partnerë ndërkombëtarë si Agjencia Franceze për Zhvillim. Ai i shton vlerë këtij grupi punimesh si ushtrimi i parë i vlerësimit të kostove i realizuar në Shqipëri duke

përdorur instrumentin e kostimit të politikave të UN Women/ILO-s[18].

Pjesa e mbetur e studimit është e strukturuar si më poshtë: seksioni 2 paraqet kontekstin demografik të Shqipërisë, nevojat për kujdes dhe mungesat në shërbime; seksioni 3 paraqet kuadrin konceptual, metodologjinë dhe burimet e të dhënave; seksioni 4 paraqet gjetjet kryesore nga analiza e kostos; seksioni 5 paraqet përfundimet; dhe seksioni 6 parashtron rekomandimet.

18 UN Women, ILO (2021). *Policy Tool: Care Economy*. Available at: https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2021/04/policy-tool-care-economy

III. KUADRI KONCEPTUAL, QASJA ANALITIKE DHE METODOLOGJIA

3.1 Kuadri konceptual: Ekonomia e Përkujdesit

Ekonomia e përkujdesit përfshin një gamë të gjerë aktivitetesh produktive, si të paguara ashtu edhe të papaguara, të cilat janë thelbësore për ruajtjen e mirëqenies fizike, psikologjike dhe sociale të individëve gjatë gjithë ciklit të jetës. Ajo përfshin ofrimin e kujdesit për fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi ndryshe dhe personat e sëmurë, si dhe aktivitetet e përditshme që mbështesin familjet dhe mundësojnë funksionimin e shoqërisë dhe ekonomisë (UN Women, ILO, 2021)[19]. Përtej funksionit të saj social, ekonomia e përkujdesit luan një rol themelor ekonomik. Duke siguruar mirëqenien dhe riprodhimin e popullsisë, ajo mbështet zhvillimin e kapitalit njerëzor, ruan ofertën e punës dhe mundëson funksionimin efikas të tregjeve të punës. Aksesi në shërbimet e kujdesit është një faktor kyç që mundëson pjesëmarrjen e grave në punësim të paguar, duke e bërë investimin në ekonominë e përkujdesit si një domosdoshmëri sociale ashtu edhe një shtytës të rritjes ekonomike gjithëpërfshirëse.

Një tipar përcaktues i ekonomisë së përkujdesit është pjesa e konsiderueshme e punës së papaguar të kujdesit, e realizuar kryesisht nga gratë e familjeve. Kjo përfshin si aktivitetet e e drejtpërdrejta ashtu edhe ato të tërthorta të kujdesit, si dhe format e kujdesit në nivel mbijetese dhe atij me bazë në komunitet, të cilat mbeten kryesisht të padukshme në statistikat ekonomike. Në të njëjtën kohë, ekonomia e përkujdesit përfshin një sektor në rritje të shërbimeve të kujdesit të paguar, të ofruara nëpërmjet arsimit, kujdesit shëndetësor, shërbimeve shoqërore, si dhe shërbimeve shtëpiake dhe personale në sferat publike dhe private. Këto shërbime shpesh plotësojnë ose zëvendësojnë kujdesin e papaguar dhe përbëjnë një burim të rëndësishëm punësimi. Si në fushën e punës së paguar ashtu edhe në atë të papaguar, puna e kujdesit mund të kuptohet si një vazhdimësi e aktiviteteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, një dallim që është i rëndësishëm për analizimin e përdorimit të kohës, alokimit të punës dhe organizimit të sistemeve të kujdesit.

Për të udhëhequr analizën dhe orientimin e politikave të këtij studimi, kuadri konceptual bazohet në kuadrin e UN Women–ILO për transformimin e sistemeve të kujdesit,

19 Women, ILO (2021). Policy Tool: Care Economy. Available at: https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2021/04/policy-tool-care-economy

veçanërisht në qasjen 6R[20]: Njohja, Reduktimi, Rishpërndarja, Shpërblimi, Përfaqësimi dhe Burimet. Ky kuadër thekson se politikat efikase të kujdesit duhet të:

- **Të njohin** vlerën ekonomike dhe sociale të punës së kujdesit, si të papaguar ashtu edhe të paguar.
- **Të zvogëlojnë** përgjegjësitë e kujdesit të papaguar, të cilat kërkojnë kohë dhe punë intensive, veçanërisht ato që mbarten në mënyrë disproporcionale nga gratë.
- **Të rishpërndajnë** përgjegjësitë e kujdesit në mënyrë më të barabartë ndërmjet grave dhe burrave, si dhe ndërmjet familjeve, shtetit, sektorit privat dhe komuniteteve.
- **Të shpërblejnë** punonjësit e kujdesit të paguar nëpërmjet pagave të mira, kushteve të denja të punës dhe mbrojtjes sociale
- **Të përfaqësojnë** kujdestarët dhe përfituesit e kujdesit në proceset vendimmarrëse, duke siguruar që nevojat dhe të drejtat e tyre të pasqyrohen në politika dhe planifikim
- **Të financojnë** sistemet e kujdesit nëpërmjet financimit publik të qëndrueshëm dhe të përgjigjshëm gjinor, duke siguruar që investimet të jenë të përshtatshme, të parashikueshme dhe në përputhje me objektivat e politikave.

Së bashku, ky kuadër konceptual e pozicionon ekonominë e përkujdesit jo vetëm si një sektor që kërkon mbështetje sociale, por edhe si një zonë strategjike për investime publike, me potencialin për të gjeneruar punësim, për të promovuar barazinë gjinore dhe për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

3.2 Përkufizime kryesore

Për të siguruar qartësinë e koncepteve dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare, studimi parashtron përkufizimet e mëposhtme:

- **Puna e kujdesit:** Të gjitha aktivitetet, të paguara ose të papaguara, që kontribuojnë në përmbushjen e nevojave fizike, emocionale dhe zhvillimore të individëve.
- **Punë e drejtpërdrejtë kujdesi:** Ndërveprimet person-me-person që adresojnë drejtpërdrejt nevojat e kujdesit (p.sh., ushqyerja, mësimdhënia, ndihma për personat e moshuar, ofrimi i kujdesit shëndetësor).

20 Kuadri 5R-ve të kujdesit i referohet njohjes, reduktimit dhe shpërndarjes së punës së pa paguar të kujdesit, ndërsa gjithashtu shpërblen dhe përfaqëson punonjësit e kujdesit të paguar. Kuadri i 6R-ve ndërton mbi këtë duke shtuar "burimet," që thekson nevojën për financim të mjaftueshëm, infrastrukturë, shërbime dhe kapacitet institucional për të mbështetur sistemet e kujdesit.

- **Puna e tërthortë (jo e drejtpërdrejtë) kujdesi:** Aktivitete mbështetëse që mundësojnë ofrimin e kujdesit të drejtpërdrejtë (p.sh. gatimi, pastrimi, larja e rrobave, menaxhimi i familjes).

- **Puna e papaguar e kujdesit:** kryhet brenda familjeve për konsum vetjak; përfshin të gjitha shërbimet e papaguara të ofruara nga individët brenda një familjeje ose komuniteti në dobi të anëtarëve të tyre, duke përfshirë kujdesin e drejtpërdrejtë ndaj personave (siç është kujdesi për fëmijët, personat e moshuar dhe personat me sëmundje ose aftësi të kufizuara), si dhe punën jo të drejtpërdrejtë të kujdesit në shtëpi që është e nevojshme për mirëqenien (siç është gatimi, pastrimi dhe larja). Puna vullnetare në komunitet që mbështet kujdesin personal ose shtëpiak, siç janë mencat në komunitet ose kujdesi për fëmijët, janë gjithashtu forma të punës së papaguar të kujdesit.

- **Puna e paguar e kujdesit:** ofrohet nëpërmjet sektorëve të arsimit, shëndetësisë dhe punës sociale. Puna e paguar e kujdesit përfshin si sferat publike, ashtu edhe ato private dhe ofrohet në një sërë mjedisesh, si në ekonomitë formale ashtu edhe në ato joformale, brenda dhe jashtë familjeve.

- **Punonjësit e kujdesit:** Një punonjës që kujdeset për nevojat fizike, psikologjike, emocionale dhe zhvillimore të të tjerëve në kuadër të një marrëdhënieje pune. Punonjësit e kujdesit përfshijnë një gamë të gjerë punonjësish në arsim, shëndetësi, punë sociale, shërbime të kujdesit personal dhe punë shtëpiake.

Këto dallime janë thelbësore për matjen e punës së kujdesit, identifikimin e pabarazive gjinore dhe hartimin e ndërhyrjeve të synuara në politika.

3.3 Qasja analitike dhe metodologjia

Duke u mbështetur në instrumentin e politikave të UN Women-ILO[21] dhe kuadrin e investimeve në shërbimet e kujdesit, ky studim përdor një qasje analitike të integruar, të bazuar në fakte, e cila lidh mungesat në shërbimet e kujdesit me rezultatet ekonomike. Kjo qasje pasqyron premisën qendrore të kuadrit të UN Women dhe ILO-së se investimi në shërbimet e kujdesit gjeneron një dividend të trefishtë: avancimin e barazisë gjinore, krijimin e vendeve të punës dhe mbështetjen e rritjes ekonomike të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Ajo e pozicionon ekonominë e kujdesit jo vetëm si një sektor social, por

21 UN Women dhe Organizata Ndërkombëtare e Punës (2021). "Udhëzues për Investimet Publike në Ekonominë e Përkujdesit: Instrument Mbështetës i Politikave për Vlerësimin e Mungesave në Kujdes, Kostove të Investimeve dhe Përfitimeve Ekonomike". Nju Jork dhe Gjenevë: UN Women dhe Organizata Ndërkombëtare e Punës. Në dispozicion në faqen: https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2021/04/policy-tool-care-economy

edhe si një fushë strategjike për investime publike.

Për ta vënë në funksion këtë kuadër, studimi zbaton Instrumentin e Simulimit për Investime në Politikat e Kujdesit të UN Women-ILO (2021). Metodologjia përcakton identifikimin e mangësive në kujdes (boshllëqe në mbulimin dhe aksesin e shërbimeve), përfshirë:

i. Vlerësimi i nevojave për investime të domosdoshme për mbylljen e këtyre mungesave

ii. Vlerësimi i përfitimeve ekonomike, duke përfshirë krijimin e vendeve të punës dhe efektet fiskale

Analiza përqendrohet në dy sektorë kryesorë: 1. Kujdesi dhe Edukimi në Fëmijërinë e Hershme (ECCE) dhe 2. Kujdesi Afatgjatë (LTC) për personat e moshuar.

Metodologjia zbatohet në tre hapa kryesorë:

i. Vlerësimi i mungesave në mbulimin e kujdesit, bazuar në të dhënat e popullsisë dhe objektivat e politikave të harmonizuara me standardet e BE-së.

ii. Vlerësimi i kostove për mbylljen e këtyre boshllëqeve, duke përfshirë si komponentët e pagave ashtu edhe ato jo-pagë, duke garantuar standardet e cilësisë dhe kushte të mira pune.

iii. Vlerësimi i krijimit të drejtpërdrejtë të vendeve të punës, duke përfshirë si punonjësit e kujdesit ashtu edhe personelin mbështetës, bazuar në kërkesat për ofrimin e shërbimeve.

Duke kombinuar analizën e mangësive në mbulimin me shërbime, vlerësimin e kostove dhe parashikimin e përfitimeve, studimi ofron një kornizë të fortë dhe të rëndësishme për politikat, për të vlerësuar ndikimet ekonomike dhe sociale të investimeve në ekonominë e përkujdesit në Shqipëri.

Hapi 1: Vlerësimi i boshllëqeve në mbulimin e shërbimeve të kujdesit

Boshllëku në Mbulimin e Kujdesit (CCG) mat diferencën midis popullsisë që ka nevojë për shërbime kujdesi dhe asaj që aktualisht mbulohet. Ai llogaritet duke përdorur të dhënat e popullsisë dhe objektivat e politikave të harmonizuara me standardet e BE-së (p.sh., objektivat e Barcelonës).[22]

$$CCG_{mosha} = (P_{mosha} \times tcr_{mosha}) - (P_{mosha} \times ccr_{mosha}) \quad (1)$$

Ku:

CCG_{mosha} = Boshllëku në mbulimin e kujdesit për një grupmoshë të caktuar (d.m.th. numri shtesë i individëve që duhet të mbulohen nga shërbimet)

P_{mosha} = Popullsia totale në grupmoshën përkatëse

tcr_{mosha} = Shkalla e synuar e mbulimit (pjesa e synuar e popullsisë që duhet të marrë shërbime kujdesi, bazuar në treguesit dhe standardet e politikave)

ccr_{mosha} = Shkalla aktuale e mbulimit (pjesa ekzistuese e popullsisë që aktualisht merr shërbime kujdesi)

Ky hap identifikon numrin shtesë të përfituesve që duhet të mbulohen me shërbime për të arritur objektivat e politikave dhe shërben si bazë për vlerësimet e mëvonshme të kostove dhe të punësimit.

22 Objektivat e Barcelonës i referohen udhëzimeve të Bashkimit Evropian (BE) për të rritur pjesëmarrjen e grave në tregun e punës duke zgjeruar arsimin dhe kujdesin për fëmijët në moshë të hershme.

Hapi 2: Vlerësimi i kostove të investimeve

Vlerësimi i kostos për mbylljen e mungesës së shërbimeve në arsim mbështetet në dy elementë kryesorë:

i. Numri i vendeve shtesë të nevojshme për regjistrimin e fëmijëve/nxënësve të rinj;

ii. Kostoja për fëmijë/nxënës, e përshtatur për të përmbushur standardet e cilësisë, me të dy elementët të ndarë sipas grupmoshave dhe nivelit të arsimit.

Shpenzimet ndahen në dy komponentë:

i. Pagat dhe shpërblimet për stafin mësimdhënës;

ii. Kostot e tjera operative, përfshirë pagat e stafit administrativ, materialet mësimore, qiranë, mirëmbajtjen dhe shpenzimet e tjera administrative jo-pagë.

Ndarja e komponentit të kostove operative lejon përllogaritjen e kostove të përgjithshme për fëmijë/nxënës vetëm për shpenzimet operative, të veçuar nga pagat e stafit mësimdhënës. Kostot e stafit mësimdhënës mund të rregullohen më pas për të përmbushur raportet e dëshiruara fëmijë/nxënës dhe nivelet e pagave.

Kostoja totale llogaritet si shuma e shpenzimeve totale për paga dhe shpërblime të stafit me shpenzimet totale operative:

$$CostECGi = Shpenzimet\ e\ pagave_i + Shpenzimet\ operative_i \quad (2)$$

Kjo qasje siguron se vlerësimet e kostove pasqyrojnë jo vetëm zgjerimin e shërbimeve, por edhe përmirësimet në cilësi dhe kushtet e punës, në përputhje me agjendën për punë dinjitoze në sektorin e kujdesit.

Kostoja e mbylljes së boshllëqeve në mbulimin me shërbime të kujdesit afatgjatë (LTC) vlerësohet duke përdorur qasjen e bazuar në fuqinë punëtore. Kjo qasje llogarit numrin shtesë të punonjësve të LTC-së që nevojiten për të plotësuar boshllëkun e mbulimit, si dhe kostot vjetore përkatëse, duke përfshirë pagat e synuara dhe shpenzimet e përgjithshme administrative/operative.

$$\textbf{\textit{Kostoja e boshllëkut të mbulimit për LTC = Numri shtesë i punonjësve FTE të LTC-së që kërkohen x Paga vjetore e synuar për një punonjës FTE të LTC-së + kostot e përgjithshme shpenzimet e përgjithshme administrative dhe operative}} \quad (3)$$

Hapi 3: Vlerësimi i krijimit të punësimit të drejtpërdrejtë

Vlerësimi i krijimit të punësimit të drejtpërdrejtë mbështetet në analizën e mëparshme të mangësive në mbulimin e shërbimeve të kujdesit dhe të kostove. Boshllëku në Mbulimin e Kujdesit (CCG) në ekuacionin (1) tregon numrin shtesë të përfituesve të shërbimit që duhet të mbulohen. Pjesëtimi i këtij numri me raportin e synuar përfitues-ofrues shërbimi (t.s.r) jep numrin e ofruesve shtesë të shërbimeve të nevojshme për të mbuluar CCG.

Numri i punonjësve të kujdesit të nevojshëm llogaritet si vijon:

$$\textbf{\textit{Punonjësit e kujdesit}} = \frac{\textbf{\textit{CCG}}}{\textbf{\textit{t.s.r}}} \quad (4)$$

Ku ***t.s.r*** përfaqëson raportin e synuar të shërbimit (përfitues për punonjës kujdesi)

Punësimi total përfshin:

- Punonjësit e drejtpërdrejtë të kujdesit (p.sh. mësues, kujdestarë, infermierë
- Punonjësit mbështetës (p.sh., personel administrativ dhe shërbimi)

$$D.E._{cw} = N_{ofruesit} + N_{mbështetje} \quad (5)$$

Ku:

$D.E._{cw}$ = Krijimi i punësimit të drejtpërdrejtë në sektorin e kujdesit

$N_{ofruesit}$ = Numri i ofruesve shtesë të shërbimeve, të nevojshëm për të mbyllur boshllëkun në mbulimin e kujdesit (CCG)

$N_{mbështetje}$ = Numri i stafit shtesë jo-mësimdhënës (mbështetës) të nevojshëm

Kostot për mbylljen e mangësive në mbulimin e shërbimeve dhe në cilësi marrin parasysh përmirësimet në cilësinë e shërbimeve dhe pagat e denja për punonjësit e kujdesit. Për të vlerësuar mungesat në mbulimin e kujdesit në sektorin e ECCE-së dhe të kujdesit afatgjatë për të moshuarit (LTC), përdoren objektivat e përcaktuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (2018), të përshtatura sipas nevojës në bazë të legjislacionit kombëtar dhe Strategjisë së Kujdesit të Bashkimit Europian (BE). Këto objektiva paraqiten në seksionin e rezultateve.

3.4 Burimet e të dhënave

Analiza mbështetet në një kombinim të burimeve kombëtare të të dhënave statistikore dhe administrative për të siguruar një vlerësim gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të mangësive në kujdes, nevojave për investime dhe përfitimeve ekonomike. Këto burime të dhënash përdoren në mënyrë të integruar për të mbështetur hapat e ndryshëm të metodologjisë, duke përfshirë matjen e punës së papaguar të kujdesit, vlerësimin e boshllëqeve në mbulimin e shërbimeve, kostimin dhe analizën e punësimit.

Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave, 2023

Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave (2023) siguron bazën demografike për vlerësimin e nevojave për kujdes dhe të mangësive në mbulimin e shërbimeve.

Treguesit kryesorë përfshijnë:

i. Popullsinë e moshës 0-3 vjeç (e rëndësishme për kujdesin dhe edukimin në fëmijërinë e hershme)
ii. Popullsinë e moshës 65+ vjeç (e rëndësishme për kujdesin afatgjatë)
iii. Numrin e fëmijëve të regjistruar në shërbimet e kujdesit për fëmijërinë e hershme

Anketa e Përdorimit të Kohës, 2010

Anketa e Përdorimit të Kohës ofron të dhëna thelbësore për matjen e kujdesit të papaguar dhe punës shtëpiake, një komponent thelbësor i ekonomisë së kujdesit. Analiza mbështetet në informacionin mbi kohën mesatare (orë dhe minuta) të shpenzuar në aktivitetet kryesore, të ndara sipas gjinisë dhe grupmoshave (10+ dhe 15–64), duke mbuluar të gjitha ditët e javës.

Anketa e Përdorimit të Kohës (TUS) ofron një ndarje të detajuar të punës së papaguar, duke përfshirë:

i. Mirëmbajtjen e shtëpisë (përgatitja e ushqimit, pastrimi, larja e rrobave, riparimet)
ii. Aktivitetet e kujdesit (kujdesi për fëmijët dhe të rriturit)
iii. Aktivitete të tjera të papaguara (blerje, vullnetarizëm dhe udhëtime të lidhura me punën e papaguar)

Anketa e Kostove të Punës, 2020

Anketa e Kostos së Punës jep të dhëna kyçe për vlerësimin e kostove të ofrimit të shërbimeve të kujdesit, veçanërisht në lidhje me inputet e punës dhe strukturat e pagave.

Analiza përdor:

- **i.** Kostot mesatare të punës për orë
- **ii.** Mesataren vjetore të orëve të punës (duke përjashtuar bujqësinë)

Të dhënat administrative për pagat dhe shpërblimet

Të dhënat administrative për pagat dhe shpërblimet përdoren për të siguruar që vlerësimet e kostove pasqyrojnë kushtet aktuale të tregut të punës në sektorët e kujdesit.

Analiza mbështetet në:

- **i.** Pagat mesatare sipas sektorit, veçanërisht në arsim, shëndetësi dhe shërbime shoqërore
- **ii.** Nivelet e pagës minimale të zbatueshme në nivel kombëtar

3.5 Kufizimet

Analiza është e lidhur me disa kufizime që duhet të merren parasysh gjatë interpretimit të rezultateve.

Së pari, vlerësimi i punës së papaguar të kujdesit mbështetet në të dhënat e Anketës së Përdorimit të Kohës (2011), të cilat mund të mos pasqyrojnë plotësisht modelet aktuale të përdorimit të kohës dhe përgjegjësitë e kujdesit, veçanërisht në kuadër të zhvillimeve të fundit social-ekonomike. Përveç kësaj, përdorimi i të dhënave të përdorimit të kohës nga viti 2011 së bashku me treguesit më të fundit makroekonomikë (p.sh. PBB-ja e vitit 2023) paraqet një mospërputhje në kohë. Meqenëse modelet e përdorimit të kohës kanë tendencë të ndryshojnë gradualisht, këto vlerësime duhet të interpretohen me kujdes.

Së dyti, ndërsa kuadri metodologjik i UN Women dhe Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) lejon vlerësimin e disa sektorëve të kujdesit — përfshirë kujdesin dhe edukimin në fëmijërinë e hershme (ECCE), kujdesin afatgjatë dhe shëndetësinë — studimi aktual fokusohet vetëm në dy sektorë: ECCE (0–6 vjeç) dhe kujdesin afatgjatë për të moshuarit. Si rezultat, analiza nuk kap tërë gamën e nevojave për kujdes dhe ndikimet e mundshme në të gjitha fushat e kujdesit.

Së treti, studimi fokusohet në vlerësimin e punësimit të gjeneruar brenda sektorit të kujdesit, duke përfshirë si punonjësit e kujdesit të drejtpërdrejtë (p.sh. mësuesit, kujdestarët) ashtu edhe stafin mbështetës (p.sh. personelin administrativ dhe të shërbimit), të cilët trajtohen si punësim i drejtpërdrejtë në përputhje me instrumentin e simulimit të politikave të UN Women-ILO. Efektet e punësimit përtej sektorit të kujdesit - siç është krijimi jo i drejtpërdrejtë dhe i induktuar i vendeve të punës, i cili rrjedh nga zinxhirët e furnizimit dhe

lidhjet më të gjera ekonomike - nuk përfshihen në analizë. Në veçanti, studimi nuk përfshin modelimin input-output apo qasje më të gjera të modelimit makroekonomik, të cilat janë jashtë objektit të metodologjisë së përzgjedhur. Si rrjedhojë, ndikimi i përgjithshëm në punësim nga investimet në kujdes mund të vlerësohet në mënyrë konservatore.

Së katërti, instrumenti i simulimit të politikave UN Women-ILO nuk përfshin kostot e investimeve në infrastrukturën fizike (p.sh. ndërtimi, zgjerimi ose përmirësimi i objekteve të kujdesit). Si rrjedhojë, vlerësimet e kostove të paraqitura në këtë studim pasqyrojnë kryesisht kostot operative të ofrimit të shërbimeve dhe mund të nënvlerësojnë investimin total të nevojshëm për zgjerimin e sistemeve të kujdesit.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, studimi zbaton një kuadër metodologjik solid dhe të njohur e pranuar në nivel ndërkombëtar, duke ofruar një bazë të qëndrueshme dhe të rëndësishme për politikëbërësit për vlerësimin e rastit për investime në ekonominë e përkujdesit në Shqipëri.

IV. GJETJET KRYESORE NGA ANALIZA KOSTO-PËRFITIM

4.1 Mangësitë në mbulimin e shërbimeve dhe shpenzimet e nevojshme për shërbimet në ECCE

Mangësitë në mbulimin e shërbimeve në ECCE-së (0-3 vjeç)

Analiza tregon se 37% e fëmijëve të moshës 0-3 vjeç përfshihen nga shërbimet e kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme (ECCE), një përqindje e ulët krahasuar me objektivin e vendosur nën Strategjinë Evropiane të Kujdesit dhe Objektivat e Barcelonës, të cilat specifikojnë një normë përfshirjeje prej 50% për këtë grupmoshë (Tabela 1). Kjo do të thotë se 63% e fëmijëve të moshës 0–3, që përbëjnë gjithsej 11,774 fëmijë, nuk përfshihen nga shërbimet ECCE.

Të dhënat dhe supozimet e mëposhtme u përdorën për të llogaritur këto rezultate:

- Sipas të dhënave të Censit të vitit 2023, në Shqipëri jetojnë 89,163 fëmijë të moshës 0-3 vjeç. Nga këta, gjithsej 32,808 fëmijë (37%) janë të regjistruar në shërbimet e kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme.
- Bazuar në shkallën e synuar të regjistrimit në ECCE prej 50%, të përcaktuar nga Strategjia Europiane e Kujdesit, 44,582 fëmijë të tjerë të moshës 0-3 vjeç duhet të regjistrohen në ECCE për të arritur këtë objektiv.
- Numri i synuar i fëmijëve në nivel ndërkombëtar për çdo mësues për këtë grupmoshë është vendosur midis 3 dhe 10 fëmijëve për çdo mësues.
- Duke supozuar një raport prej 7 fëmijësh për çdo mësues, numri i mësuesve të nevojshëm për të plotësuar këtë mungesë është 1,682.
- Duke supozuar një mësues ndihmës për çdo mësues, duhen edhe 1,682 mësues ndihmës.
- Duke vendosur pagën e mësuesit në nivelin e pagës mesatare kombëtare, pagën e mësuesit ndihmës në nivelin e pagës minimale kombëtare, duke caktuar shpenzimet operative për çdo fëmijë në 70% të kostos së pagës për çdo fëmijë dhe një numër shtesë të personelit jomësimdhënës për çdo nxënës (staf administrativ dhe mbështetës) në 25%, kosto e përgjithshme për mbulimin e shërbimeve të munguara vlerësohet të jetë rreth 4.0 miliardë lekë.

Kostoja totale për mbulimin e shërbimeve të munguara përfaqëson rreth 0,2% të PBB-së aktuale.

Mangësitë në mbulimin me shërbime në ECCE (4-6 vjeç)

Analiza tregon se 62 % e fëmijëve të moshës 4-6 vjeç mbulohen nga shërbimet e kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme (ECCE), një përqindje e ulët krahasuar me objektivin e vendosur nën Strategjinë Evropiane të Kujdesit dhe Objektivat e Barcelonës, të cilat specifikojnë një normë përfshirjeje prej 100%. Kjo tregon se 38% e fëmijëve në këtë grup-moshë, që përbëjnë gjithsej 27,255 fëmijë, nuk përfshihen nga shërbimet ECCE.

Të dhënat dhe supozimet e mëposhtme u përdorën për të llogaritur këtë shifër:

- Sipas të dhënave të Censit të vitit 2023, në Shqipëri jetojnë 71,556 fëmijë të moshës 4-6 vjeç. Nga këta, 44,301 fëmijë (62% janë të regjistruar në shërbimet e kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme.
- Bazuar në shkallën e synuar të regjistrimit prej 100%, të përcaktuar nga Strategjia Europiane e Kujdesit, të gjithë 71,556 fëmijët duhet të jenë të regjistruar për të arritur këtë objektiv.
- Numri i synuar i fëmijëve në nivel ndërkombëtar për çdo mësues për këtë grupmoshë është vendosur midis 15 dhe 20.
  - Duke marrë kufirin e poshtëm prej 15 fëmijësh për çdo mësues, numri i mësuesve të nevojshëm për të plotësuar mungesën është 1,817.
  - Duke supozuar një mësues ndihmës për çdo mësues, nevojiten gjithashtu 1,817 mësues ndihmës.
- Duke vendosur pagën e mësuesit në nivelin e pagës mesatare kombëtare të grave në sektorët e arsimit, shëndetësisë dhe shërbimeve sociale, pagën e mësuesit ndihmës në nivelin e pagës minimale kombëtare, duke përcaktuar shpenzimet operative për çdo fëmijë në 70% të kostos së pagave për çdo fëmijë, si dhe duke llogaritur stafin shtesë jo-mësimdhënës (administrativ dhe mbështetës) në masën 30%, kosto totale për mbulimin e shërbimeve të munguara vlerësohet të jetë rreth 6.6 miliardë lekë.

Kostoja totale për mbulimin e shërbimeve të munguara është e barabartë me rreth 0.3% të PBB-së aktuale.

Mbështetur në rezultatet e mësipërme, mungesa në mbulimin e shërbimeve të kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme (ECCE) për fëmijët e moshës 0-6 vjeç arrin në 39,029 fëmijë. Mbyllja e këtij boshlleku do të kërkonte një investim të vlerësuar prej afërsisht 10.6 miliardë lekësh, ekuivalent me rreth 0.45% të PBB-së aktuale.

4.2 Mangësitë në mbulimin e shërbimeve dhe shpenzimet e nevojshme për shërbimet e Kujdesit Afatgjatë

Analiza tregon se 37,849 persona të moshuar (65 vjeç e lart) nuk mbulohen nga shërbimet e kujdesit afatgjatë (LTC). Ky vlerësim bazohet në të dhënat dhe supozimet e mëposhtme:

- Sipas Censit të vitit 2023, në Shqipëri ka 473,104 individë të moshës 65 vjeç e lart.
- Vlerësimet e UNDP-së[23] tregojnë se 3,705 të moshuar janë në qendra ditore dhe qendra rezidenciale, dhe vetëm 5% marrin shërbime nga persona që nuk janë anëtarë të familjes.
- Vlerësimet e UNDP-së[24] tregojnë se 3,705 të moshuar janë në qendra ditore dhe qendra rezidenciale, dhe vetëm 5% marrin shërbime nga jo-anëtarë të familjes.
- Bazuar në një normë të synuar prej 13%[25] për mbulimin e shërbimeve të kujdesit afatgjatë për të moshuarit 65 vjeç e lart, numri total i personave që duhet të mbulohen arrin në 61,504.
- Duke marrë parasysh normën prej 5% të mbulimit nga persona jashtë familjes, mungesa në mbulimin e shërbimeve të kujdesit afatgjatë për të moshuarit është 37,849.
- Duke vendosur raportin e synuar prej 10 punonjësish të kujdesit afatgjatë për 100 të moshuar, nevojiten 6,150 punonjës të kujdesit afatgjatë për të arritur këtë objektiv.
- Duke u bazuar në vlerësimet e UNDP-së për 3,700 punonjës aktualë në kujdesin afatgjatë, rezulton se nevojiten gjithsej 2,450 punonjës të tjerë të kujdesit afatgjatë për të plotësuar boshllëkun në mbulimin e shërbimeve.
- Duke vendosur pagën e punonjësve të kujdesit afatgjatë në nivelin e pagës mesatare kombëtare të grave në sektorët e arsimit, shëndetësisë dhe shërbimeve sociale, pagën e stafit shtesë në nivelin e pagës minimale kombëtare, si dhe duke llogaritur staf shtesë për 100 të moshuar në masën 20%, kostoja totale për mbulimin e shërbime të munguara vlerësohet të jetë rreth 2.6 miliardë lekë.

Kostoja totale e mbulimit të shërbimeve të munguara përfaqëson rreth 0.11% të PBB-së aktuale.

23 UNDP (2025). "Moshimi në Shqipëri: Vështrime mbi Kujdesin Afatgjatë për të Moshuarit."

24 UNDP (2025). "Moshimi në Shqipëri: Vështrime mbi Kujdesin Afatgjatë për të Moshuarit."

25 Objektivi i vendosur pak më i lartë se objektivi prej 12.4% i vendosur në Instrumentin e politikave bazuar në kontekstin kombëtar.

Mungesa totale e mbulimit për kujdesin dhe edukimin në fëmijërinë e hershme dhe kujdesin afatgjatë arrin në 76,878 individë, me një kosto totale të vlerësuar për mbulimin prej 13.2 miliardë lekë, e cila përfaqëson rreth 0.56% të PBB-së aktuale.

TABELA 1

Mungesat në mbulim dhe kostot në sektorët e kujdesit

	Boshllëku në Mbulim	Kosto e mbylljes së Boshllëkut në Mbulim (ALL)	Kosto e Mungesës së Mbulimit/PBB (përqind)
Nënsektorët e Shërbimeve të Kujdesit			
Kujdesi dhe Edukimi në Fëmijërinë e Hershme - ECCE (0-3)	11,774	4,019,506,539	0.17
Kujdesi dhe Edukimi në Fëmijërinë e Hershme - ECCE (4-6)	27,255	6,592,112,340	0.28
Kujdesi dhe Edukimi në Fëmijërinë e Hershme - Totali	39,029	10,611,618,879	0.45
Kujdesi afatgjatë	37,849	2,568,068,208	0.11
Totali për Kujdesin dhe Edukimin në Fëmijërinë e Hershme dhe Kujdesin Afatgjatë	76,878	13,179,687,087	0.56

Burimi: Censi i Popullsisë i INSTAT për vitin 2023 dhe përllogaritjet e autorit

KOSTOJA TOTALE PËR MBULIMIN E SHËRBIMEVE TË MUNGUARA



4.3 Ndikimi i investimeve në Kujdesin dhe Edukimin në Fëmijërinë e Hershme dhe Kujdesin Afatgjatë për krijimin e vendeve të punës

Mbështetur në objektivin për mbulimin e Kujdesit dhe Edukimit në Fëmijërinë e Hershme dhe Kujdesit Afatgjatë dhe Kujdesin Afatgjatë, mungesat përkatëse të mbulimit, raportin fëmijë-mësues, si dhe punonjësit e kujdesit afatgjatë për 100 persona të moshuar, do të krijohen gjithsej 11,869 vende të reja pune të drejtpërdrejta duke plotësuar mungesat në mbulimin me shërbimet në ECCE dhe LTC (Tabela 2). Bazuar në të dhënat e tregut të punës sipas Anketës së Forcës së Punës[26] (LFS) të vitit 2022, gratë përbëjnë afërsisht 75% të forcave të punës në sektorët e kujdesit. Duke ruajtur të njëjtën strukturë të forcave të punës në sektorët e kujdesit, 8,902 vende të reja pune të drejtpërdrejta duhet të mbulohen nga gratë.

Këto 11,869 vende të reja pune ndahen në 8,929 vende pune të krijuara nga kujdesi dhe arsimi në fëmijërinë e hershme, dhe 2,940 vende pune në kujdesin afatgjatë. Vendet e punës në kujdesin dhe arsimin e hershëm për fëmijët ndahen në 4,205 vende të krijuara për grupmoshën 0–3 vjeç, dhe 4,724 vende për grupmoshën 4–6 vjeç. Për grupmoshën 0–3 vjeç në kujdesin dhe arsimin e hershëm për fëmijët, vlerësohet se 3,364 vende pune janë për personelin e kujdesit, ndërsa 841 vende për punonjës të tjerë. Për grupmoshën 4–6 vjeç, vlerësohet se 3,634 vende pune janë për personelin e kujdesit, dhe 1,090 vende për punonjës të tjerë. Sa i përket vendeve të punës në kujdesin afatgjatë, 2,450 janë për personelin e kujdesit, ndërsa 490 për punonjës të tjerë.

26 Charmes, J., Juna Miluka dhe A. Shima. 2023. Ekonomia e Përkujdesit në Shqipëri dhe Rasti për Investime në Institucionet e Kujdesit në Fëmijërinë e Hershme. Mimeo. I disponueshëm sipas kërkesave.

TABELA 2

Ndikimi i drejtpërdrejtë në punësim i investimeve në kujdesin social (numri i vendeve të reja të punës)

	Punonjës kujdesi	Punonjës të tjerë	Punësim i drejtpërdrejtë totali
Nënsektorët e Shërbimeve të Kujdesit			
Kujdesi dhe Edukimi në Fëmijërinë e Hershme - ECCE (0-3)	3,364	841	4,205
Kujdesi dhe Edukimi në Fëmijërinë e Hershme - ECCE (4-6)	3,634	1,090	4,724
Kujdesi dhe Edukimi në Fëmijërinë e Hershme - Totali	6,998	1,931	8,929
Kujdesi Afatgjatë	2,450	490	2,940
Totali për Kujdesin dhe Edukimin në Fëmijërinë e Hershme dhe Kujdesin Afatgjatë	9,448	2,421	11,869

Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në Instrumentin e politikave të UN Women dhe ILO

Fatura totale e pagave bazuar në krijimin e punësimit të drejtpërdrejtë nga ekonomia e përkujdesit vlerësohet në 8.0 miliardë lekë, nga e cila fatura totale e pagave për ECCE shkon në 5.2 miliardë lekë dhe fatura totale e pagave për kujdesin afatgjatë arrin në 2.8 miliardë lekë (Tabela 3).

- Bazuar në llogaritjet e faturës së pagave, merren vlerësimet e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore.
- Llogaritja e TVSH-së bëhet duke supozuar se fatura neto e pagave përdoret për konsum. Fatura neto e pagave përftohet pas zbritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të paguara nga punëmarrësit në masën 9.5%..
- Norma e TVSH-së llogaritet si mesatare e kufijve të poshtëm dhe të sipërm, përkatësisht 6% dhe 13%.
- Vlerësimi i TVSH-së arrin në 935 milionë lekë, nga të cilat 606 milionë lekë vijnë nga totali i ECCE-së dhe 330 milionë lekë nga kujdesi afatgjatë.
- Duke përdorur normën totale të kontributeve të sigurimeve shoqërore prej 24.5%, kontributet e sigurimeve shoqërore vlerësohen në një total prej 1.9 miliardë lekësh, nga të cilat 1.3 miliardë lekë vijnë nga totali i ECCE-së dhe 687 milionë lekë të mbetura vijnë nga kujdesi afatgjatë.

- Kontributet totale të sigurimeve shoqërore arrijnë në 0.08% të PBB-së.
- Të ardhurat totale shtetërore vlerësohen si totali i TVSH-së dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Të ardhurat totale shtetërore të përftuara nga krijimi i punësimit të drejtpërdrejtë nga ekonomia e përkujdesit vlerësohen në 2.9 miliardë lekë, nga të cilat 1.9 miliardë lekë janë nga totali i ECCE-së dhe 1.0 miliardë janë nga kujdesi afatgjatë. Të ardhurat totale shtetërore të gjeneruara nga punësimi i drejtpërdrejtë i krijuar nga ekonomia e përkujdesit arrijnë në 0.12% të PBB-së.

TABELA 3

Pagat, të ardhurat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore - ndikimi i investimeve në kujdesin social (lek)

	Fatura e Pagave[27]	TVSH	Kontributet e Sigurimeve Shoqërore	Totali i të ardhurave shtetërore
Nënsektorët e Shërbimeve të Kujdesit				
Kujdesi dhe Edukimi në Fëmijërinë e Hershme - ECCE (0-3)	2,371,216,539	278,973,626	580,948,052	859,921,678
Kujdesi dhe Edukimi në Fëmijërinë e Hershme - ECCE (4-6)	2,776,412,340	326,644,912	680,221,023	1,006,865,935
Kujdesi dhe Edukimi në Fëmijërinë e Hershme - Totali	5,147,628,879	605,618,538	1,261,169,075	1,866,787,613
Kujdesi Afatgjatë	2,802,849,000	329,755,185	686,698,005	1,016,453,190
Totali për Kujdesin dhe Edukimin në Fëmijërinë e Hershme dhe Kujdesin Afatgjatë	7,950,477,879	935,373,722	1,947,867,080	2,883,240,803

Burimi: Përllogaritjet e autorit

27 Buxheti i pagave të personelit të kujdesit përllogaritet bazuar në numrin e vendeve të reja të punës të krijuara në secilin prej sektorëve të kujdesit, duke u vlerësuar me pagën mesatare kombëtare për ECCE 0-3; sipas pagës mesatare kombëtare të grave në arsim, shëndetësi dhe shërbime sociale për ECCE 4-6, si dhe për kujdesin afatgjatë. Buxheti i pagave për punonjësit e tjerë përllogaritet në bazë të numrit të vendeve të reja të punës të krijuara për secilin prej sektorëve të kujdesit, duke u vlerësuar me pagën minimale kombëtare.

KRIJIMI I VENDEVE TË PUNËS



KTHIMET FISKALE

4.4 Përllogaritja e ekuivalentit të punonjësve me kohë të plotë në punë të papaguar

Ndërkohë që seksionet e mësipërme mbështeten në instrumentin e politikave të UN Women – ILO dhe llogaritjen e kostove për mbulimin e mungesave në shërbimet e kujdesit për ECCE dhe kujdesin afatgjatë (LTC), ky studim vlerëson gjithashtu shkallën dhe vlerën ekonomike të punës së papaguar të kujdesit, e cila kryesisht nuk llogaritet në statistikat ekonomike konvencionale. Këto llogaritje (të cilat nuk janë pjesë e instrumentit të politikave) ofrojnë prova mbi shkallën e punës së papaguar të kujdesit dhe perspektivën e saj gjinore, si dhe ndihmojnë për përgatitjen e politikave të kujdesit, investimeve dhe rishpërndarjes së përgjegjësive të kujdesit. Kontributi në PBB dhe PBB-në e zgjeruar përllogarit vlerën e punës së papaguar për të treguar rëndësinë e saj ekonomike.

APK tregon një pabarazi të madhe midis burrave dhe grave në lidhje me punën totale të papaguar. Bazuar në popullsinë e moshës mbi 10 vjeç[28], vajzat dhe gratë shpenzojnë

28 APK mbledh të dhëna për popullsinë e moshës 10+ vjeç, si dhe për popullsinë 15-64 vjeç. Meqenëse vërehet se puna e kujdesit fillon që në një moshë të hershme, janë përfshirë edhe vlerësimet për popullsinë mbi 10 vjeç. Janë përfshirë gjithashtu llogaritjet për popullsinë 15-64 vjeç.

mesatarisht 314 minuta në punë të papaguar krahasuar me vetëm 52 minuta për djemtë dhe burrat (Tabela 4). Kjo do të thotë se vajzat dhe gratë angazhohen në punë të papaguar kujdesi 6 herë më shumë se burrat. Në një grupmoshë më të kufizuar midis 15 dhe 64 vjeç, e cila korrespondon me popullsinë në moshë pune, puna totale e papaguar për vajzat dhe gratë arrin në 347 minuta, ndërsa për djemtë dhe burrat arrin një total prej 50 minutash.

Pjesa më e madhe e punës së papaguar për vajzat dhe gratë 10 vjeç e lart përqendrohet në përgatitjen e ushqimit dhe larjen e enëve (02:07 orë), pastrimin dhe mirëmbajtjen e shtëpisë (01:12 orë), kujdesin për fëmijët (00:39 orë), si dhe larjen dhe hekurosjen (00:33 orë). Të dhëna të ngjashme, por me nivele pak më të larta, vërehen edhe për grupmoshën 15–64 vjeç. Angazhimi i burrave në kategoritë e sipërpërmendura të punës së papaguar është mesatarisht rreth 5 minuta. Përqendrimi i tyre kryesor i punës së papaguar lidhet me kopshtarinë, ndërtimin dhe riparimet (00:14 orë), megjithëse edhe angazhimi i vajzave dhe grave në këtë aktivitet është i ngjashëm.

TABELA 4

Koha mesatare (në orë dhe minuta) e shpenzuar në aktivitetin kryesor sipas gjinisë, popullsisë 10 vjeç e lart dhe 15-64 vjeç (në të gjitha ditët e javës)

	Popullsia e moshës 10+ vjeç			Popullsia e moshës 15-64 vjeç		
Aktiviteti kryesor	**Gra**	**Burra**	**Të gjithë**	**Gra**	**Burra**	**Të gjithë**
Totali i punës së paguar	01:57	04:17	03:06	02:22	05:12	03:46
Përgatitja e ushqimit, larja e enëve	02:07	00:05	01:06	02:20	00:04	01:12
Pastrimi dhe mirëmbajtje të tjera	01:12	00:06	00:40	01:20	00:06	00:43
Larja e rrobave, hekurosje, punime artizanale dhe prodhim tekstilesh	00:33	00:00	00:17	00:37	00:00	00:19
Kopshtari, ndërtim dhe riparime	00:13	00:14	00:13	00:13	00:13	00:13
Blerje dhe shërbime	00:09	00:06	00:08	00:10	00:06	00:08
Kujdesi për fëmijë	00:39	00:04	00:22	00:47	00:05	00:26
Kujdesi për të rritur	00:04	00:01	00:02	00:03	00:01	00:02
Punë tjetër e papaguar	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00	00:00
Udhëtime të lidhura me punën e papaguar	00:12	00:10	00:11	00:13	00:10	00:11
Punë vullnetare dhe ndihmë	00:01	00:02	00:02	00:01	00:02	00:01
Totali i punës së papaguar	05:14	00:52	03:04	05:47	00:50	03:19
Totali i kohës së studimit	00:56	00:57	00:57	00:41	00:39	00:40
Totali i kohës së lirë	04:07	05:33	04:50	03:46	05:12	04:29
Totali i aktiviteteve personale	11:39	12:13	11:56	11:19	12:00	11:39
Të tjera	00:04	00:04	00:04	00:04	00:03	00:04
Totali	24	24	24	24	24	24

Burimi: Anketa e Përdorimit të Kohës 2011, Tabelat A1 dhe A5

Shënime: 1. Aktiviteti "Punë vullnetare dhe ndihmë" është zhvendosur nga "koha e lirë" në "punë të papaguar".

2. Kohëzgjatjet e aktiviteteve në një Anketë të Përdorimit të Kohës duhet të interpretohen duke marrë parasysh se ato përfaqësojnë një mesatare gjatë javës dhe vitit. Koha e kaluar në punë të paguar nuk është 8 orë në ditë, sepse përfshin fundjavat, pushimet, sëmundjet, etj., dhe gjithashtu merr parasysh të gjithë individët që nuk kryejnë asnjë aktivitet të paguar.

Të dhënat e APK-së mbi punën e papaguar ofrojnë bazën për përllogaritjen e ekuivalentit të punonjësve me kohë të plotë, gjë që shërben për të njohur vlerën e punës së kujdesit të papaguar, duke e krahasuar atë me punësimin me kohë të plotë në punësimin formal. Vlerësimet e ekuivalentit të punonjësve me kohë të plotë përdoren gjithashtu në vlerësimin e kontributit të punës së papaguar të kujdesit në PBB dhe PBB-në e zgjeruar.[29]

Përllogaritja e ekuivalentit të punonjësve me kohë të plotë[30] të angazhuar në punë të papaguar bazohet në sa vijon:

i. Llogaritjet bëhen si për grupmoshën 10 vjeç e lart, ashtu edhe për popullsinë në moshë pune 15-64 vjeç.

ii. Koha mesatare e shpenzuar për secilin aktivitet përllogaritet për të gjitha ditët e javës dhe sipas metodologjisë së anketës, merren parasysh ndryshimet sezonale. Kjo do të thotë se një vlerësim vjetor mund të merret duke e shumëzuar me 365 ditë.

iii. Numri total i minutave në vit dhe për person, sipas gjinisë, shumëzohet më pas me popullsinë e moshës 10 vjeç e lart (me numrin e personave të marrë nga të dhënat e Censit të vitit 2023) në mënyrë që të merret numri total i minutave* individëve dhe më pas të konvertohet në orë duke e pjesëtuar me 60. E njëjta përllogaritje bëhet për popullsinë në moshë pune 15-64 vjeç.

iv. Për të llogaritur ekuivalentin e punonjësve me kohë të plotë, totali i marrë më sipër pjesëtohet me numrin mesatar të orëve të punuara në vit sipas Anketës së Kostos së Punës (INSTAT 2022).[31]

29 PBB-ja e zgjeruar përfshin PBB-në aktuale + vlerën e punës së papaguar të kujdesit.

30 Në vijim të Charmes, et. al. (2023).

31 INSTAT (2022). Anketa e Kostos se Punes. Tirana: INSTAT.

Ekuivalenti i punonjësve me kohë të plotë nëpunën e papaguar të kujdesit

Ekuivalenti i numrit të punonjësve me kohë të plotë në punën e papaguar të kujdesit vlerësohet duke konvertuar kohën mesatare ditore të shpenzuar në punë të papaguar në orë vjetore, duke e pjesëtuar këtë me numrin mesatar të orëve vjetore të punës së një punonjësi me kohë të plotë, dhe duke e shumëzuar me grupin përkatës të popullsisë.

$$FTE = \frac{\left(\frac{T \times 365}{60}\right)}{H} \times P$$

Ku:

FTE = ekuivalenti i punonjësve me kohë të plotë në punë të papaguar kujdesi
T = mesatarja e minutave në ditë të shpenzuara në punë të papaguar kujdesi
365 = numri i ditëve në një vit
60 = konvertimi nga minuta në orë
H = mesatarja e orëve vjetore të punës së një punonjësi me kohë të plotë, e vlerësuar në 2,122 orë
P = popullsia në grupmoshën dhe gjininë përkatëse

Popullsia e moshës 10 vjeç e lart

Duke përdorur të dhënat e APK-së të vitit 2011 dhe të dhënat e popullsisë të Censit të vitit 2023 për popullsinë e moshës 10 vjeç e lart:

$$FTE_{gra} = \frac{\left(\frac{313 \times 365}{60}\right)}{2{,}122} \times 1{,}097{,}720 = 984{,}991$$

$$FTE_{burra} = \frac{\left(\frac{50 \times 365}{60}\right)}{2{,}122} \times 1{,}067{,}109 = 152{,}959$$

$$FTE_{totali} = 984{,}991 + 152{,}959 = 1{,}137{,}950$$

Rezultatet tregojnë se puna e papaguar e kujdesit në popullsinë e moshës 10 vjeç e lart është e barabartë me 1,137,950 punonjës me kohë të plotë. Gratë përbëjnë ekuivalentin e 984,991 punonjësve me kohë të plotë, ose 86.5% të totalit, ndërsa burrat përbëjnë 159,077, ose 13.4%. Ky total përfaqëson 98.5% të totalit të të punësuarve në vitin 2023, i cili ishte 1,155,041 persona të punësuar.

Popullsia e moshës 15-64 vjeç

Duke përdorur të dhënat e APK-së të vitit 2011 dhe të dhënat e popullsisë të Censit të vitit 2023 për popullsinë në moshë pune të moshës 15-64 vjeç:

$$FTE_{gra} = \frac{\left(\frac{347 \times 365}{60}\right)}{2{,}122} \times 787{,}685 = 783{,}571$$

$$FTE_{burra} = \frac{\left(\frac{48 \times 365}{60}\right)}{2{,}122} \times 767{,}395 = 105{,}598$$

$$FTE_{totali} = 783{,}571 + 105{,}598 = 889{,}169$$

Për popullsinë në moshë pune, puna e papaguar e kujdesit është e barabartë me ekuivalentin e 889,169 punonjësve me kohë të plotë. Gratë përbëjnë ekuivalentin e 783,571 punonjësve me kohë të plotë, ose 88% të totalit, ndërsa burrat përbëjnë 105,598, ose 12%. Kjo përfaqëson 77% të totalit të të punësuarve në vitin 2023.

GRAFIKU 1

Ekuivalenti i Punonjësve me kohë të plotë në punë të papaguar (të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpëdrejtë)



Burimi: Tabela 5 në aneksin 1

4.5 Përllogaritja e ekuivalentit të punonjësve me kohë të plotë sipas llojit të punës së papaguar të kujdesit

Siç u analizua në seksionin më sipër, gratë shpenzojnë shumë më tepër kohë duke kryer punë kujdesi sesa burrat.

- Gratë 10 vjeç e lart shpenzojnë 270 minuta në ditë në kujdes jo të drejtpërdrejtë, që përfshin punët e shtëpisë, dhe 43 minuta në kujdes të drejtpërdrejtë (Tabela 5 tek Shtojca 1). Kujdesi i drejtpërdrejtë ndahet midis kujdesit për fëmijët, që arrin në 39 minuta në ditë, dhe kujdesit për të rriturit, që arrin në 4 minuta në ditë.
- Koha e shpenzuar në kujdes jo të drejtpërdrejtë dhe të drejtpërdrejtë për vajzat dhe gratë e popullsisë në moshë pune 15-64 vjeç është më e lartë me 27 minuta në ditë, duke arritur në total në 297 minuta.
- Djemtë dhe burrat 10 vjeç e lart angazhohen gjashtë herë më pak në punë kujdesi jo të drejtpërdrejtë dhe të drejtpërdrejtë krahasuar me vajzat dhe gratë 10 vjeç e lart, ndërsa ata në popullsinë në moshë pune 15-64 vjeç angazhohen shtatë herë më pak sesa vajzat dhe gratë e të njëjtës kategori moshe.

Popullsia e moshës 10 vjeç e lart

Llogaritjet sipas llojit të punës së papaguar të kujdesit tregojnë se për popullsinë 10 vjeç e lart, ekziston një total i ekuivalentit prej 987,336 punonjësish me kohë të plotë për kujdes jo të drejtpërdrejtë, ku në total vajzat dhe gratë përfaqësojnë ekuivalentin e 849,673 (86%)

të punonjësve me kohë të plotë, dhe djemtë dhe burrat ekuivalentin e 137,663 (14%) të punonjësve me kohë të plotë.

Sa i përket ekuivalentit të punonjësve me kohë të plotë në kujdesin e drejtpërdrejtë:

- Ekuivalenti i punonjësve me kohë të plotë për kujdesin e drejtpërdrejtë të fëmijëve arrin në total: 134,967, nga të cilët 122,730 (91%) janë vajza dhe gra dhe 12,237 (9.0 përqind) janë burra.
- Ekuivalenti i punonjësve me kohë të plotë për kujdesin e drejtpërdrejtë ndaj të rriturve arrin në total: 15,647, nga të cilët 12,588 (80%) janë vajza dhe gra dhe 3,059 (20%) janë burra.
- Ekuivalenti i punonjësve me kohë të plotë për kujdesin e drejtpërdrejtë arrin në total: 150,614, nga të cilët 135,318 (90%) janë vajza dhe gra dhe 15,296 (10%) janë burra.
- Ekuivalenti i punonjësve me kohë të plotë për kujdesin e drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë arrin në total: 1,137,950, nga të cilët 984,991 (87%) janë vajza dhe gra dhe 152,959 (13%) janë burra.

Popullsia e moshës 15-64 vjeç

Përllogaritjet për popullsinë në moshë pune 15-64 vjeç tregojnë ekuivalentin e një totali prej 763,063 punonjësish me kohë të plotë për kujdesin jo të drejtpërdrejtë, ku vajzat dhe gratë përbëjnë ekuivalentin e një totali prej 670,664 (88%) punonjësish me kohë të plotë dhe burrat përbëjnë ekuivalentin e një totali prej 92,398 (12%) punonjësish.

Sa i përket ekuivalentit të punonjësve me kohë të plotë në kujdesin e drejtpërdrejtë:

- Ekuivalenti i punonjësve me kohë të plotë për kujdesin e drejtpërdrejtë të fëmijëve arrin në total: 117,132, nga të cilët 106,132 (91%) janë gra dhe 11,000 (9%) janë burra.
- Ekuivalenti i punonjësve me kohë të plotë për kujdesin e drejtpërdrejtë ndaj të rriturve arrin në total: 8,974, nga të cilët 6,774 (75%) janë gra dhe 2,200 (25%) janë burra.
- Ekuivalenti i punonjësve me kohë të plotë për kujdesin e drejtpërdrejtë arrin në total: 126,106, nga të cilët 112,906 (90%) janë gra dhe 13,200 (10%) janë burra.
- Ekuivalenti i punonjësve me kohë të plotë për kujdesin arrin në total: 889,169, nga të cilët 783,571 (88%) janë gra dhe 105,598 (12%) janë burra.
- Mbështetur në këto përllogaritje, gratë do të përfitonin ndjeshëm nga investimet në sektorin e kujdesit.

GRAFIKU 2

Ekuivalenti i punonjësve me kohë të plotë sipas llojit të punës së papaguar të kujdesit



Burimi: Tabela 5 në aneksin 1

Këto shifra tregojnë numrin dukshëm më të lartë të orëve dhe minutave të shpenzuara nga gratë e të gjitha grupmoshave për përgjegjësitë e kujdesit, si të drejtpërdrejtë ashtu edhe jo të drejtpërdrejtë, si në ECCE ashtu edhe në LTC. Angazhimi më i lartë i grave në kohë për përgjegjësitë e kujdesit është identifikuar si një faktor kryesor pengues për pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës dhe në punësim. Në vitin 2023, pjesëmarrja e grave në forcat e punës për grupmoshën 15-64 vjeç ishte pothuajse 13 pikë përqindje më e ulët se ajo e burrave[32]. Përmirësimi i disponueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit mund të adresojë këto mangësi dhe të përmirësojë fuqizimin ekonomik dhe pavarësinë e grave, së bashku me përpjekjet e strukturuara për zhvillimin e forcave të punës. Ndërsa mangësitë në mbulimin me shërbime i analizuar në këtë studim nuk merr parasysh pabarazitë midis zonave rurale dhe urbane, një raport i kohëve të fundit i Kontrollit të Lartë të Shtetit[33] tregon se zonat rurale janë ato që marrin më pak shërbime kur bëhet fjalë për institucionet e kujdesit, duke rënduar sfidat me të cilat përballen gratë që jetojnë në zonat rurale në lidhje me aksesin në treg dhe mundësitë për punësim.

32 UN Women (2025). Country Gender Equality Profile — Albania. Tirana: UN Women Albania Country Office. Available at:https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2025/11/country-gender-equality-profile-albania

33 UN Women (2024). Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave rurale përmes përfshirjes në tregun e punës - Raporti përfundimtar i auditimit të performancës— Albania. Tirana: UN Women Albania Country Office. Available at: https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2024/06/gender-equality-and-the-empowerment-of-rural-women-through-labor-marketinvolvement-final-performance-audit-report

4.6 Kontributi i Ekonomisë së Përkujdesit në PBB në Shqipëri

Kontributi i ekonomisë së kujdesit në PBB dhe PBB-në e zgjeruar është i lidhur drejtpërdrejt me njohjen e punës së papaguar të kujdesit. Kontributi i ekonomisë së përkujdesit në PBB matet si kontributi i punës së papaguar në PBB dhe PBB-në e zgjeruar, duke përdorur ekuivalentin e numrit të punonjësve me kohë të plotë për popullsinë mbi 10 vjeç dhe për popullsinë në moshë aktive (15-64 vjeç) dhe duke përdorur vlera të ndryshme të pagave, si: paga mesatare bruto mujore, paga minimale mujore dhe kompensimi vjetor i punonjësve. Vlerësimet duke përdorur tre masa të ndryshme pagash dhe kostot e punës tregojnë një kontribut të konsiderueshëm të ekonomisë së përkujdesit në PBB.[34]

Popullsia e moshës 10 vjeç e lart

- Kontributi i ekonomisë së përkujdesit në PBB duke përdorur pagat mesatare bruto mujore vlerësohet në 40.7%, nga të cilat 34.1% vijnë nga gratë dhe pjesa e mbetur prej 5.6% vjen nga burrat (Tabela 6 tek Shtojca 1).
- Vlera e përllogaritur ulet në 23.1% kur përdoret paga minimale, nga e cila 20.0% i atribuohet kontributit të grave dhe 3.1% i atribuohet kontributit të burrave në këtë sektor.
- Vlerësimet duke përdorur kompensimin vjetor të punonjësve tregojnë një kontribut total prej 39.8%, nga i cili 34.5% vjen nga gratë dhe pjesa e mbetur prej 5.4% vjen nga burrat.

Studimet e mëparshme[35] kanë treguar se puna e papaguar e kujdesit dhe punëve në shtëpi do të ishte ekuivalente me afërsisht 48.8% të PBB-së në vitin 2021, kur vlerësohet sipas pagës mesatare bruto mujore.

Vlerësimet duke përdorur të njëjtën popullsi dhe strukturë të pagave dhe kostove të punës, por duke përdorur PBB-në e zgjeruar tregojnë se kontributi i ekonomisë së kujdesit në PBB-në e zgjeruar, duke përdorur pagat mesatare bruto mujore, është afërsisht 28.9%, nga të cilat 25.4% vjen nga gratë dhe 5.3% nga burrat. Vlerësimet duke përdorur pagën minimale tregojnë një kontribut prej 18.8%, nga i cili 16.7% u atribuohet grave dhe 3.0% u atribuohet burrave. Së fundi, vlerësimet duke përdorur kostot vjetore të punës tregojnë një kontribut prej 28.5%, nga i cili 25.6% vjen nga gratë dhe 5.1% nga burrat.

34 Në vijim të Charmes, etj. (2023).

35 Charmes, J., Juna Miluka dhe A. Shima. 2023. Ekonomia e Përkujdesit në Shqipëri dhe Rasti për Investime në Institucionet e Kujdesit në Fëmijërinë e Hershme. Mimeo. Në dispozicion sipas kërkesave.

Popullsia 15-64 vjeç

Për popullsinë në moshë pune (15-64 vjeç), kontributi i vlerësuar i ekonomisë së kujdesit në PBB mbetet i konsiderueshëm, megjithëse pak më i ulët se për popullsinë mbi 10 vjeç (Tabela 7 tek Shtojca 1).

Duke përdorur supozime të ndryshme për pagat, kontributi i vlerësuar në PBB është:

- 31.8% bazuar në pagat mesatare bruto mujore
- 18.1% bazuar në pagën minimale
- 31.1% bazuar në kompensimin e punonjësve

Në të gjitha rastet, gratë përbëjnë pjesën më të madhe të kontributit, duke reflektuar përfshirjen e tyre joproporcionale në punën e papaguar të kujdesit.

Vlerësimet duke përdorur të njëjtën popullatë dhe strukturë pagash dhe kosto pune, por duke përdorur PBB-në e zgjeruar tregojnë se kontributi i ekonomisë së kujdesit në PBB-në e zgjeruar vlerësohet si:

- 24.1% duke përdorur pagën mesatare
- 15.3% duke përdorur pagën minimale
- 23.7% duke përdorur kompensimin e punonjësve

GRAFIKU 3
Kontributi i punës së papaguar në PBB (në përqindje)



PËRFITIME MË TË GJERA EKONOMIKE DHE SOCIALE

Rritja e punësimit të grave	Ul përgjegjësinë e punës së papaguar të kujdesit U mundëson grave të hyjnë dhe të qëndrojnë në tregun e punës Përmirëson sigurinë e të ardhurave dhe pensionet
Mbështetja e rritjes afatgjatë	Kujdesi cilësor për fëmijët përmirëson: • Zhvillimin e aftësive • Rezultatet arsimore • Produktivitetin e ardhshëm
Përgjigje ndaj presioneve demografike	Adreson plakjen e popullsisë (rritjen e shpejtë të grupmoshës 65+) Mbështet familjet që përballen me përgjegjësi kujdesi Mund të reduktojë presionet për emigrim të lidhura me mungesën e shërbimeve
Avancimi i integrimit në BE dhe objektivave sociale	Objektivat e Strategjisë së Kujdesit të BE-së Objektivat e Strategjisë së Barazisë Gjinore të BE-së dhe Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore i BE-së (GAP IV), i cili përfshin ekonominë e përkujdesit si një objektiv kyç për arritjen e barazisë gjinore Reformat e mbrojtjes sociale Dialog i vazhdueshëm ndërmjet OKB-së dhe Qeverisë së Shqipërisë mbi Përshpejtuesin e Konvergjencës Sociale Angazhimet për barazi gjinore (SDG 5

V. PËRFUNDIME

Analiza e investimeve për kujdesin në Shqipëri, me fokus në ECCE dhe LTC për të moshuarit, vlerëson kostot dhe përfitimet e shumta që lidhen me adresimin e mungesave ekzistuese në mbulimin e këtyre shërbimeve. Kostoja e eliminimit të këtyre mangësive arrin në rreth 0.56% të PBB-së, ndërkohë që pritet që këto mungesa të rriten si pasojë e ndryshimeve demografike, plakjes së popullsisë dhe migracionit të konsiderueshëm. Analiza e këtyre prirjeve tregon gjithashtu një lidhje të ngushtë midis kohës më të madhe që gratë investojnë në kryerjen e detyrave të kujdesit krahasuar me burrat dhe shkallës në të cilën kjo kohë e papaguar mund të transformohet në punësim formal për gratë pas investimeve në shërbime cilësore të kujdesit në të gjithë Shqipërinë, sidomos në zonat rurale. Prandaj, duhet të hartohet një plan investimi që merr parasysh kërkesën në rritje për shërbime kujdesi. Investimi në ekonominë e kujdesit tregohet gjithashtu të jetë pjesërisht vetë-financues nëpërmjet krijimit të vendeve të reja të punës, të cilat vlerësohen në rreth 11,869, si dhe nëpërmjet rritjes së të ardhurave tatimore dhe kontributeve të detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe pensionet. Këto efekte fiskale pozitive vlerësohen në rreth 0.20% të PBB-së, duke mbuluar rreth 36% të kostove të përgjithshme të investimit. Duke ruajtur përbërjen aktuale gjinore të forcës së punës në sektorin e kujdesit, gratë mund të përfitojnë rreth 75% të vendeve të punës të krijuara në mënyrë të drejtpërdrejtë. Prandaj, gjetjet tregojnë se investimi në ekonominë e kujdesit mund të zgjerojë hapësirën fiskale, në vend që ta zvogëlojë atë. Në përgjithësi, investimet relativisht modeste në shërbimet e kujdesit mund të gjenerojnë përfitime të konsiderueshme ekonomike dhe sociale, duke ndihmuar njëkohësisht në zhbllokimin e vlerës së fshehur ekonomike të kujdesit të papaguar dhe punëve shtëpiake, e cila vlerësohet deri në 40.7% të PBB-së. Pavarësisht kontributit të saj thelbësor në funksionimin e ekonomisë dhe shoqërisë, kjo punë mbetet kryesisht e padukshme në matjet konvencionale ekonomike.

Kjo do të përfaqësonte një investim fitimprurës në Shqipëri: përmirësimi i aksesit në shërbime cilësore të kujdesit për fëmijët dhe kujdesit afatgjatë do të rriste cilësinë e jetës dhe mirëqenien e fëmijëve të vegjël - me efekte afatgjata në zhvillimin e kapitalit njerëzor - si dhe të të moshuarve dhe familjeve që përballen me përgjegjësi gjithnjë e më të mëdha për kujdesin, duke nxitur njëkohësisht aktivitetin ekonomik, krijimin e vendeve të punës dhe barazinë gjinore. Në të njëjtën kohë, investimi në ekonominë e kujdesit do të gjeneronte përfitime të konsiderueshme ekonomike dhe sociale duke rritur pjesëmarrjen në forcën e punës, duke forcuar aktivitetin ekonomik vendas dhe duke mbështetur një rritje më gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Është e rëndësishme të theksohet se zgjerimi i shërbimeve të kujdesit do të ndihmonte

në rishpërndarjen më të barabartë të përgjegjësive të kujdesit midis familjeve, shtetit dhe tregut, duke zvogëluar përgjegjësinë joproporcionale të grave në punën e papaguar të kujdesit dhe në punët në shtëpi. Duke zhvendosur një pjesë të konsiderueshme të punës së kujdesit nga puna e papaguar në punësim të paguar, këto investime do të lehtësonin kufizimet kohore të grave, do të mbështesnin hyrjen dhe qëndrimin e tyre në tregun e punës, do të përmirësonin sigurinë e të ardhurave dhe të drejtat e ardhshme për pensione, si dhe do të kontribuonin në zvogëlimin e diferencave gjinore në punësim, paga dhe pensione.

Investimi në ekonominë e kujdesit duhet të kuptohet jo si një kosto sociale, por si një investim strategjik social dhe ekonomik që mbështet qëndrueshmërinë demografike, mbrojtjen sociale, produktivitetin dhe barazinë gjinore. Ai është gjithashtu plotësisht në përputhje me angazhimet e Shqipërisë sipas Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, Strategjisë së BE-së për Kujdesin, Strategjisë së BE-së për Barazinë Gjinore 2026–2030, si dhe agjendës më të gjerë të integrimit të vendit në BE.

VI. REKOMANDIME

Gjetjet e studimit sugjerojnë se qeveria duhet t'i japë përparësi investimeve publike në shërbimet e kujdesit, veçanërisht ato të kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme dhe të kujdesit afatgjatë për të moshuarit, për të adresuar dhe mbyllur mungesat ekzistuese në mbulimin me shërbime në përputhje me standardet kombëtare, rajonale dhe globale. Zgjerimi i këtyre shërbimeve jo vetëm që do të përmirësojë aksesin, por do të krijojë gjithashtu mjaft mundësi punësimi. Në të njëjtën kohë, rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe krijimi i vendeve të punës në sektorin e kujdesit mund të kompensojë pjesërisht kostot nëpërmjet rritjes së të ardhurave tatimore. Këto dinamika duhet të merren parasysh në planifikimin buxhetor si në nivelin qendror ashtu edhe në atë vendor, ku përgjegjësia për ofrimin e shërbimeve të kujdesit është e ndarë. Për ta zbatuar këtë, qeveria duhet të integrojë më qartë investimet në kujdes në planifikimin buxhetor afatmesëm dhe afatgjatë si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë vendor, si dhe të harmonizojë prioritetet e politikave kombëtare me kapacitetet dhe nevojat e bashkive.

Në nivel qendror, qeveria duhet të marrë në konsideratë rishikimin e rregullit të transferimeve për arsimin parashkollor[36] për të përfshirë edukimin e hershëm të fëmijëve (0–3 vjeç), duke siguruar financim të dedikuar për çerdhet. Formulat e alokimit të burimeve duhet të përmirësohen për të drejtuar më shumë fonde drejt bashkive me përqëndrim më të lartë të fëmijëve të vegjël, mbulim më të ulët të shërbimeve dhe pjesëmarrje më të madhe të familjeve me të ardhura të ulëta. Paralelisht, forcimi i të ardhurave të qeverisjes vendore nëpërmjet futjes së taksave të reja do të mbështeste financimin më të qëndrueshëm dhe përmirësimin e menaxhimit të shërbimeve të kujdesit. Kjo, nga ana tjetër, do të ndikonte në rritjen e pjesëmarrjes së grave në forcën e punës, duke zvogëluar numrin e minutave dhe orëve që gratë i kushtojnë përgjegjësive të kujdesit, i cili është pothuajse gjashtë herë më i lartë se ai i burrave.

Duke pasur parasysh zgjerimin e parashikuar të punësimit në sektorët ECCE dhe LTC, politikat duhet të përqendrohen gjithashtu në zhvillimin e forcës së punës në sektorët që do të jenë objekt i reformave të politikave dhe punës, të cilët zakonisht dominohen nga gratë. Trajnimi i vazhdueshëm dhe zhvillimi profesional për kujdestarët janë thelbësorë për të siguruar cilësinë e kujdesit dhe për të mbështetur një fuqi punëtore të kualifikuar dhe të qëndrueshme.

36 Arsimi parafillor financohet përmes transferimeve sektorale pa kushte për bashkite nga qeverisja qendrore. Shumica e fondeve jepen bazuar në numrin e nxënësve, dhe disa prej tyre varen nga numri i mësuesve. Konkretisht, 60% e fondeve për pagat e mësuesve bazohet në numrin e nxënësve, dhe 40% bazohet në numrin e mësuesve.

Përmirësimi i cilësisë së të dhënave administrative të ndara sipas gjinisë është thelbësor. Standardizimi i mbledhjes dhe raportimit të të dhënave të kostove - veçanërisht shpenzimeve operative dhe administrative në shërbimet ECCE dhe LTC - do të bënte të mundur vlerësime më të sakta të nevojave për investime dhe do të mbështeste hartimin e politikave të bazuara në të dhëna. Zbatimi i metodologjive të standardizuara për mbledhjen e të dhënave në të gjitha bashkitë dhe ofruesit e kujdesit do të mundësonte vlerësime më të sakta të kostove për njësi dhe nevojave për investime. Këto të dhëna duhet të raportohen në mënyrë sistematike, të konsolidohen në nivel qendror dhe të bëhen të aksesueshme për analizë të politikave. Sistemet e përmirësuara të të dhënave do të mbështesnin gjithashtu monitorimin e performancës, duke u mundësuar politikëbërësve të ndjekin progresin në zgjerimin e mbulimit, përmirësimin e cilësisë dhe arritjen e objektivave të punësimit.

Së fundi, integrimi i politikave të kujdesit në një kuadër më të gjerë strategjik—duke lidhur mbrojtjen sociale, punësimin, barazinë gjinore dhe politikat e zhvillimit lokal—do të rriste ndikimin e tyre. Një strategji e hartuar mirë për ekonominë e kujdesit mund të shërbejë si një instrument për rritje gjithëpërfshirëse, duke reduktuar pabarazitë dhe duke nxitur një forcë pune më të qëndrueshme dhe më produktive.

Mund të merren gjithashtu në konsideratë një sërë alternativash investimi[37], si bazë për financimin e investimeve në ekonominë e kujdesit:

- Ekziston mundësia e rialokimit të shpenzimeve drejt investimeve që zgjerojnë kapacitetin fiskal, në vend të atyre që e zvogëlojnë atë, siç janë përjashtimet nga TVSH-ja. Përjashtimet nga TVSH-ja38, veçanërisht ato që lidhen me arsimin dhe shëndetësinë private, shërbimet financiare dhe të sigurimeve, transaksionet e pronësisë së patundshme, etj., mund të eliminohen për të zgjeruar bazën tatimore, për të rritur mbledhjen e të ardhurave dhe për të përmirësuar efikasitetin dhe barazinë e sistemit tatimor. Një pjesë e të ardhurave shtesë të fituara mund të alokohet për financimin e shërbimeve të kujdesit.
- Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjinor (BPGj) luan një rol të rëndësishëm në prioritizimin e investimeve publike në shërbimet e kujdesit. BPGj mund të shoqërohet me një monitorim solid në të gjitha fazat e planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit të

37 Në vijim të Miluka, J. (2025). "Mobilizimi i burimeve për kujdes: Një qasje holistike për financimin e shërbimeve universale të kujdesit në Shqipëri." Përmbledhja e Qendrës Brookings për Zhvillim të Qëndrueshëm "Inovacionet në financat publike: Një paradigmë e re fiskale për barazinë gjinore, përshtatjen ndaj klimës dhe kujdesin."

38 Memorandumi Ekonomik për Shqipërinë: Forcimi i Qëndrueshmërisë së Modelit të Rritjes së Shqipërisë." 2025. Banka Botërore. Raport i brendshëm, nuk është i disponueshëm për publikun.

buxhetit, dhe mbi të gjitha në vlerësimin e shpenzimeve reale dhe ndikimit të tyre.

- Partneritetet publike-private (PPP) dhe iniciativat me bazë në komunitet mund të ndihmojnë në zgjerimin e shërbimeve të kujdesit duke ndarë kostot dhe rreziqet, ndërkohë që mobilizojnë investimet dhe ekspertizën private për të përmirësuar efikasitetin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit. Megjithatë, pa mbikëqyrje të fortë, ato mund të kompromet ojnë aksesin, cilësinë dhe qëndrueshmërinë fiskale, veçanërisht nëse motivet e fitimit tejkalojnë objektivat e barazisë dhe mbulimit universal.
- Financimi ndërkombëtar - sidomos nga BE-ja - mund të mbështesë zgjerimin e ekonomisë së kujdesit në zonat me shërbime të pamjaftueshme. Programe si IPA III, ESF, EU4Social Protection dhe EU4Employment ofrojnë burime për infrastrukturën sociale, punën e kujdesit dhe barazinë gjinore, në përputhje me prioritetet e anëtarësimit të Shqipërisë në BE.
- Tarifat e kufizuara sipas të ardhurave, të kombinuara me kredi tatimore ose subvencione të synuara, mund të përmirësojnë përballueshmërinë dhe aksesin në kujdesin për fëmijët. Edhe pse struktura progresive e tarifave është në dobi të prindërve me të ardhura të ulëta, kufiri i tarifës mund të inkurajojë mbështetjen për prindërit me të ardhura të mesme dhe të larta. Këto modele kanë rezultuar të suksesshme në vende[39] si Gjermania, Danimarka, Norvegjia dhe Finlanda.
- Angazhimi i komuniteteve lokale dhe partneriteti me OJQ-të mund të ulë kostot, të forcojë pronësinë lokale dhe të zgjerojë shërbimet e kujdesit - sidomos ato në zonat rurale - duke përmirësuar njëkohësisht shtrirjen te grupet e cenueshme. Në këtë drejtim, ligji për sipërmarrjet sociale mund të zgjerojë objektin e tij për të përfshirë edhe OSHC-të që ofrojnë shërbime kujdesi. Megjithatë, zbatimi efikas kërkon koordinim dhe mbikëqyrje të fortë dhe financim të qëndrueshëm.

39 Dougherty, S. and Morabito, C. (2023). 'Gender-Responsive Budgeting: Trends and Country Approaches.' OECD Journal on Budgeting, 23(2). Available at: https://www.oecd.org/en/publications/oecd-journal-on-budgeting-volume-2023-issue-2_79ab69f5-en.html

VII. SHTOJCA 1:
TABELAT E REZULTATEVE NGA USHTRIMI PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË PAPAGUAR TË KUJDESIT

TABELA 5

Ekuivalenti i Punonjësve me kohë të plotë për punën e papaguar të kujdesit sipas gjinisë

	Popullsia 10+			Popullsia 15-64		
	Gra	Burra	Totali	Gra	Burra	Totali
Popullsia	1,097,720	1,067,109	2,164,829	787,685	767,395	1,555,080
Numri mesatar i orëve të punuara në vit*	2,122	2,122		2,122	2,122	
Koha e kaluar në kujdes jo të drejtpërdrejtë (punë shtëpiake) në minuta në ditë	270	45		297	42	
Koha e kaluar në kujdes të drejtpërdrejtë (fëmijë) (minuta në ditë)	39	4		47	5	
Koha e kaluar në kujdes të drejtpërdrejtë (i rritur) (minuta në ditë)	4	1		3	1	
Koha e kaluar në kujdes të drejtpërdrejtë (totali) (minuta në ditë)	43	5		50	6	
Koha e kaluar për kujdes (të drejtpërdrejtë + jo të drejt-përdrejtë) (minuta në ditë)	313	50		347	48	
Ekuivalenti i punonjësve me kohë të plotë për kujdesin jo të drejtpërdrejtë (punë shtëpiake)	849,673	137,663	987,336	670,664	92,398	763,063
Ekuivalenti i punonjësve me kohë të plotë për kujdesin e drejtpërdrejtë (fëmijë)	122,730	12,237	134,967	106,132	11,000	117,132
Ekuivalenti i punonjësve me kohë të plotë për kujdesin e drejtpërdrejtë (të rritur)	12,588	3,059	15,647	6,774	2,200	8,974
Ekuivalenti i punonjësve me kohë të plotë për kujdesin e drejtpërdrejtë (totali)	135,318	15,296	150,614	112,906	13,200	126,106
Ekuivalenti i punonjësve me kohë të plotë për kujdes (të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë)**	984,991	152,959	1,137,950	783,571	105,598	889,169

Burimi: INSTAT, APK (TUS) 2011; Përllogaritjet e autorit për ekuivalentin e punonjësve me kohë të plotë

Shënime: *Numri mesatar i orëve të punuara në vit është interpoluar për vitet midis anketave.
**Këto shifra nuk përfshijnë vullnetarizmin dhe ndihmën për familjet e tjera, për të cilat nuk mund të bëhet dallimi midis kujdesit të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë.

TABELA 6

Kontributi i punës së papaguar në PBB dhe në PBB të zgjeruar sipas ekuivalentit të punonjësve me kohë të plotë dhe vlerave të ndryshme të pagave, popullsia 10+ vjeç

	Popullsia 10+		
	Gra	**Burra**	**Totali**
Ekuivalenti i punonjësve me kohë të plotë	984,991	152,959	1,137,950
Paga mesatare bruto mujore	68,183	72,681	70,539
Paga minimale mujore	40,000	40,000	40,000
Kompensimi i punonjësve (vjetor)			827,534
(1) Vlera e shtuar me pagat mesatare bruto	805,915,485,967.60	133,406,552,632.35	963,238,038,877.51
(2) Vlera e shtuar me pagën minimale	472,795,556,644.68	73,420,317,624.88	546,215,874,269.56
(3) Vlera e shtuar me kompensimin e punonjësve	815,113,329,525.82	126,578,769,011.23	941,692,098,537.05
PBB me çmimet aktuale			2,364,276,000,000
PBB e zgjeruar			
PBB me çmimet aktuale + (1)	3,170,191,485,967.60	2,497,682,552,632.35	3,327,514,038,877.51
PBB me çmimet aktuale + (2)	2,837,071,556,644.67	2,437,696,317,624.88	2,910,491,874,269.56
PBB me çmimet aktuale + (3)	3,179,389,329,525.82	2,490,854,769,011.23	3,305,968,098,537.05
përqindja e PBB-së (1) (paga mesatare bruto mujore)	34.1	5.6	40.7
përqindja e PBB-së (2) (paga minimale)	20.0	3.1	23.1
përqindja e PBB-së (3) (kompensimi i punonjësve)	34.5	5.4	39.8

	Popullsia 10+		
	Gra	**Burra**	**Totali**
përqindja e PBB-së së Zgjeruar (1) (paga mesatare bruto mujore)	25.4	5.3	28.9
përqindja e PBB-së së Zgjeruar (2) (paga minimale)	16.7	3.0	18.8
përqindja e PBB-së së Zgjeruar (3) (kompensimi i punonjësve)	25.6	5.1	28.5

Burimi: INSTAT dhe përllogaritjet e autorit

TABELA 7

Kontributi i punës së papaguar në PBB dhe në PBB të zgjeruar sipas ekuivalentit të numrit të punonjësve me kohë të plotë dhe vlerave të ndryshme të pagave, popullsia 15-64 vjeç

	Popullsia 15-64 vjeç		
	Gra	Burra	Totali
Ekuivalenti i punonjësve me kohë të plotë	783,571	105,598	889,169
Paga mesatare bruto mujore	68,183	72,681	70,539
Paga minimale mujore	40,000	40,000	40,000
Kompensimi i punonjësve (vjetor)			827,534
(1) Vlera e shtuar me pagat mesatare bruto	641,114,554,806.08	92,099,776,685.43	752,653,151,597.21
(2) Vlera e shtuar me pagën minimale	376,114,019,509.90	50,687,126,861.45	426,801,146,371.35
(3) Vlera e shtuar me kompensimin e punonjësve	648,431,539,627.30	87,386,085,083.68	735,817,624,710.97
PBB me çmimet aktuale			2,364,276,000,000
PBB e zgjeruar			
PBB me çmimet aktuale + (1)	3,005,390,554,806.08	2,456,375,776,685.43	3,116,929,151,597.21
PBB me çmimet aktuale + (2)	2,740,390,019,509.90	2,414,963,126,861.45	2,791,077,146,371.35
PBB me çmimet aktuale + (3)	3,012,707,539,627.30	2,451,662,085,083.68	3,100,093,624,710.97
përqindja e PBB-së (1) (paga mesatare bruto mujore)	27.1	3.9	31.8
përqindja e PBB-së (2) (paga minimale)	15.9	2.1	18.1
përqindja e PBB-së (3) (kompensimi i punonjësve)	27.4	3.7	31.1
përqindja e PBB-së së Zgjeruar (1) (paga mesatare bruto mujore)	21.3	3.7	24.1
përqindja e PBB-së së Zgjeruar (2) (paga minimale)	13.7	2.1	15.3
përqindja e PBB-së së Zgjeruar (3) (kompensimi i punonjësve)	21.5	3.6	23.7

Burimi: INSTAT dhe përllogaritjet e autorit

VIII. REFERENCAT

Charmes, J., Juna Miluka, and A. Shima. 2023. Ekonomia e Përkujdesit në Shqipëri dhe Rasti për Investime në Institucionet e Kujdesit në Fëmijërinë e Hershme. Mimeo. I disponueshëm sipas kërkesave.

Dougherty, Sean, and Christian Morabito. 2023. "OECD Journal on Budgeting." OECD Publishing 2023 (2). https://www.oecd.org/en/publications/oecd-journal-on-budgeting-volume-2023-issue-2_79ab69f5-en.html.

European Commission (2022). "Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions on the European Care Strategy."

Gëdeshi, I., and King, R. (2020). ALBANIAN RETURNED ASYLUM-SEEKERS: RE-INTEGRATION OR RE-EMIGRATION?

Qeveria e Shqipërisë (2025). "Ligji Nr. 64/2025 Për Barazinë Gjinore." https://qbz.gov.al/eli/fz/2025/229/b69d770a-44f9-4a06-990c-64b22c7f1d09;q=ligji%20per%20barazine%20gjinore%202025

ILO (2024). "Resolution concerning decent work and the care economy."

ILO (2022). "Long-Term Care for the Elderly in Albania: Challenges and Key Policy Issues." Budapest: ILO. https://www.ilo.org/sites/default/files/wcmsp5/groups/public/@europe/@ro-geneva/@sro-budapest/documents/publication/wcms_846063.pdf.

ILO. (2021). "Review of Social Protection System in Albania". Review of the Social Protection System in Albania-2021-06-01.indd

INSTAT. "Censi 2023."
https://www.instat.gov.al/al/temat/censet/censet-e-popullsis%C3%AB-dhe-banesave/#tab2

INSTAT. (2024). "Censi i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri 2." https://www.instat.gov.al/en/publications/books/2024/albanian-population-and-housing-census-2023/.

INSTAT (2023). "Statistikat e Migracionit."

Miluka, J. (2025). "Mobilizing resources for care: A holistic approach for financing Albania's universal care services." The Brookings Center for Sustainable Development compendium "Innovations in public finance: A new fiscal paradigm for gender equality, climate adaptation, and care."

OECD (2025). OECD and the Sevilla Platform for Action Seville on Financing Care Systems. https://www.oecd.org/en/about/projects/oecd-and-the-sevilla-platform-for-action.html

Fletorja zyrtare, VKM nr. 400, 30.06.2021, Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e saj të Veprimit 2021-2030. MShMS (2021).

UNDP (2025). "Aging in Albania Insights into Long-Term Care for the Older Adults."

UNICEF and EuroPartners Development (2023). "Policy options for Early Childhood Education Financing in Albania."

United Nations (2024). Transforming Care Systems: UN System Policy Paper. https://unsdg.un.org/resources/transforming-care-systems-un-system-policy-paper

United Nations (2024). Pact for the Future. https://www.un.org/pact-for-the-future/en

United Nations (2021). Our Common Agenda – Report of the Secretary-General. https://www.un.org/en/content/common-agenda-report/assets/pdf/Common_Agenda_Report_English.pdf

UN Women and International Labour Organization (2021). "A Guide to Public Investments in the Care Economy: Policy Support Tool for Estimating Care Deficits, Investment Costs and Economic Returns". New York and Geneva: UN Women and International Labour Organization. Available at https://www.unwomen.org/sites/default/files/Headquarters/Attachments/Sections/Library/Publications/2021/Policy-tool-Careeconomy-en.pdf

World Economic Forum W(2024). White Paper "The Future of the Care Economy".

World Bank Group (2023). Addressing Care to Accelerate Equality. https://openknowledge.worldbank.org/entities/publication/4ec36a0c-ced2-4826-9e4f-51ec66eec7bf

World Bank (2025). Albania Country Economic Memorandum: Strengthening the Sustainability of Albania's Growth Model." Internal report, not publicly available.

UN WOMEN ËSHTË KRIJUAR PËR TË AVANCUAR TË DREJTAT E GRAVE, BARAZINË GJINORE DHE FUQIZIMIN E TË GJITHA GRAVE DHE VAJZAVE.

UN Women është krijuar për të avancuar të drejtat e grave, barazinë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave.

Si enti drejtues i Kombeve të Bashkuara për barazinë gjinore dhe sekretariat i Komisionit për Statusin e Grave, ne punojmë për të ndryshuar ligjet, institucionet, sjelljet shoqërore dhe shërbimet, me qëllim mbylljen e hendekut gjinor dhe ndërtimin e një bote të barabartë për të gjitha gratë dhe vajzat. Partneritetet tona me qeveritë, lëvizjet e grave dhe sektorin privat, së bashku me rolin tonë koordinues në kuadër të sistemit të Kombeve të Bashkuara, i kthejnë përparimet në ndryshime të qëndrueshme. Puna jonë për avancimin e të drejtave të grave dhe vajzave përqendrohet në katër fusha kyçe: lidershipi, fuqizimi ekonomik, mbrojtja nga dhuna, roli i grave në paqe dhe siguri, si dhe veprimi humanitar.

UN Women i vendos të drejtat e grave dhe vajzave në qendër të përparimit global—gjithmonë dhe kudo. Sepse barazia gjinore nuk është vetëm ajo që bëjmë. Barazia gjinore është ajo që jemi.

UN WOMEN FOR ALL WOMEN AND GIRLS

Str. Skenderbej, P. 8, 2nd floor,
Ap. 29,30,31, Tirana, Albania

albania.unwomen.org
facebook.com/unwomenalbania
instagram.com/unwomenalbania